



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
STUDIME TË CIKLIT TË DYTË

TEMA:

**ORGANIZIMI, MENAXHIMI DHE FUNKSIONIMI I
MEDRESESË NË RMV**

Kandidati:

KURTALI KURTISHI

Mentori:

PROF. DR. AGRON RUSTEMI

TETOVË, 2022

Përmbajtje

HYRJE	5
1. KAPITULLI I – DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I MEDRESEVE.....	7
1.1 DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I MEDRESEVE	7
1.2 Institucionet arsimore në fillim të Islamit	8
1.3 Historiku i medreseve	9
1.4 Funksionimi i medresesë - qasje e përgjithshme	12
1.5 Femra muslimane dhe arsimimi	14
1.6 Jeta shoqërore dhe Medreseja.....	15
1.7 Faktorët socio-ekonomikë.....	16
1.8 Kurrikula e medreseve	16
1.9 Medresetë nëpër botë	18
2. KAPITULLI II – ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I MEDRESESË NË RMV	23
2.1 ARSIMIMI NË MAQEDONI	23
2.2 Sibjan-mektebet	24
2.3 Medresetë në Maqedoni.....	25
2.4 Historiku i medresesë “Isa Beu”	26
2.5 Gazi Isa Beu.....	27
2.6 Medreseja “Isa Beu” pas vitit 1984 dhe shtrirja e saj fizike	29
2.6.1 Paralelja e djemve – Shkup	31
2.6.2 Paralelja e vajzave – Tetovë	33
2.6.3. Paralelja e djemve – Shtip	34
2.6.4. Paralelja e vajzave – Shkup	35
2.6.5. Paralelja e vajzave – Gostivar	35
3. KAPITULLI III – MENAXHIMI I MEDRESESË “ISA BEU”	36
3.1 Çështjet juridike, organizative dhe financiare të Medresesë “Isa Beu”	36
3.2 Rregullorja e medresesë “Isa Beu”	37
3.3 Planprogrami i SHMI Medreseja “Isa Beu”	39

3.4 Drejtori i medresesë "Isa Beu"	40
 4. KAPITULLI IV – HULUMTIMI EMPIRIK MBI ORGANIZIMIN, MENAXHIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MEDRESEË NË RMV	41
4.1 Metodologjia	42
4.2 Lënda e hulumtimit	42
4.3 Qëllimet e hulumtimit.....	43
4.4 Hipotezat e hulumtimit	44
4.5 Metodatat e përdorura për vlerësimet cilësore dhe sasore.....	45
4.5.1 Metoda e grumbullimit të të dhënave	45
4.5.2 Intervistat me institucione përkatëse	46
4.6 Rezultatet nga hulumtimi empirik.....	47
Fig. 1 – Përqindja e të anketuarve.	48
Fig. 2. E kam zgjedhur medresenë sepse(maksimum dy përgjigje):	49
Fig. 3. Medreseja është një shkollë që funksionon mirë:	49
Fig. 4. Udhëheqësit e shkollës dhe profesorët a janë në dispozicion të dëgjojnë problemet e nxënësve dhe të gjejnë zgjidhje:	50
Fig. 5. Sekretari i shkollës ofron shërbime të mjaftueshme:	51
Fig. 6. Profesorët bashkëpunojnë për të garantuar një funksionim të mirë të shkollës:.....	51
Fig. 7. Medreseja ofron literaturë mjaftueshëm për nevojat e nxënësve:	52
Fig. 8. Klasat janë të rregulluara mirë dhe i plotësojnë kushtet për mësim:	53
Fig. 9. Hapësirat në dispozicion ju përgjigjen nevojave të nxënësve:	53
Fig. 10. Ka kujdes për sigurinë e brendshme të shkollës (dalja e emergjencës, plani i emergjencës):.....	54
Fig. 11. Profesorët dhe nxënësit janë të informuar për planin e emergjencës:	54
Fig. 12. Shenjat e daljes së emergjencës duken qartë:	55
Fig. 13. Medreseja angazhohet të shpërndajë ideologjitë e saja jashtë shkollës:	56
Fig. 14. Faqja e internetit të medresesë na ndihmon për informim:	56
Fig. 15. Objektet e medresesë duhet të rinovohen:	57
Fig. 16. Profesorët janë të gatshëm të dialogojnë me nxënësit:	57
Fig. 17. Informacionet e rëndësishme për aktivitetet e medresesë më komunikohen në mënyrë të qartë:	58
Fig. 18. Kur kam nevojë për ndonjë informacion e di kujt t'i drejtohem:	58
Fig. 19. Informohem për aktivitetet e ndryshme didaktike të medresesë:	59
Fig. 20. Në vendimet që merren nga medreseja këndvështrimi i nxënësve merret në konsideratë:	59
Fig. 21. Medreseja ofron hapësira individuale për nxënësit që duan të mësojnë pas orarit mësimorë:	60
Fig. 22. Përdorimi i regjistrit elektronik për të komunikuar disiplinën, vlerësimin, materialet didaktike, mungesat, vonesat, ndihmon:	60
Fig. 23. Çdo profesor përdorë metodologji didaktike dhe strategji edukative të ndryshme:.....	61
Fig. 24. Strategjitë dhe metodologjitë e përdorura nga profesorët janë valide dhe efikase:.....	62
Fig. 25. Planprogrami mësimorë është i qartë dhe i rregulluar si duhet:	62
Fig. 26. Detyrat e shtëpisë jepen në mënyrë të ekuilibruar:.....	63
Fig. 27. Testimet e lëndëve të ndryshme planifikohen me kohë paraprake të mjaftueshme për përgatitjen e nxënësve:	63
Fig. 28. Çdo profesor komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente mënyrën e vlerësimit të testimit:	64
Fig. 29. Profesorët iu ofrojnë nxënësve që gjejnë vështirësi mënyrë efikase për të rikuperuar:	64

Fig. 30. Nxënësit më të mirë marrin mirënjohje:.....	65
Fig. 31. Medreseja ofron një nivel të lartë të përgatitjes:	65
Fig. 32. Raportet mes nxënësve dhe medresesë janë miqësore dhe tolerante:.....	66
Fig. 33. Nxënësit e medresesë respektojnë rregullat interne:	67
Fig. 34. Profesorët promovojnë relacione pozitive (dëgjim, dialog, inkurajim) në mes të nxënësve:	67
Fig. 35. Profesorët i marrin në konsideratë problematikat e nxënësve:.....	68
 KONKLuzion	 68
 REKOMANDIM	 69
 10. Intervista me dekanin e Fakultetin e Shkencave Islame – Shkup, Prof.Dr. Shaban Sulejmani (14.05.2022)	 Error! Bookmark not defined.
 BIBLIOGRAFIA	 70

Hyrje

Procesi arsimorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është një proces i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm. Një shkollë që funksionon mirë, pa marrë parasysh publike apo private, është thelbësore për krijimin e kuadrove të ndryshme, dhe për krijimin e reformave të nevojshme strukturore për rritjen e inteligjencës në mesin e shoqërisë. Arsimit i mirë ndikon në edukimin e gjeneratave, i edukon ata të jenë të sjellshëm në shumë fusha të jetës dhe të jenë të ndërgjegjshëm ndaj obligimeve me të cilat do të ballafaqohen gjatë jetës. Kjo është një sfidë e njohur e shumë vendeve që synojnë mirëqenien e tyre si shtet. Sa i përket arsimit në Maqedoninë e Veriut, medresetë kanë luajtur një rol të rëndësishëm, veçanërisht në vendet e banuara me mysliman. Prej medreseve më të njohura dhe më të dalluara në Maqedoninë e Veriut është medreseja “Isa Beu”, e cila është vatra nëpër të cilën kaluan shumë teolog mysliman para se të vazhdonin studimet e tyre brenda dhe jashtë vendit. Kjo medrese përveç se edukoi shumë gjenerata të gjinisë mashkullore, ajo nuk e la pas dore gjininë femërore. Në Republikën e Maqedonisë Veriore medreseja “Isa Beu” posedon tre paralele të gjinisë femërore, të cilat edukojnë një numër të madh të nxënësve. Kjo shkollë e mesme islame, e cila njihet si Shkolla e Mesme Islame “Isa Beu” – Shkup, në kurrikulën e saj përveç lëndëve fetare, ajo posedon edhe lëndë të shkencave natyrore dhe shoqërore, të cilat mësohet në të gjitha shkollat e mesme në Maqedoninë e Veriut. Edhe pse kjo shkollë plotëson të gjitha kriteret e një shkolle të mesme, ministria e arsimit akoma heziton për akreditimin e kësaj shkolle pa mos dhënë ndonjë arsye konkrete. Kjo medrese ka mbijetuar nga donatorët mysliman të cilët gjithmonë i kanë dalur në ndihmë dhe vazhdojnë ta ndihmojnë, pasi burimi i vetëm financiar i kësaj shkolle vjen nga vetë popullata myslimane që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. Medreseja “Isa Beu” e ka prioritet akreditimin e saj, edhe pse është një shkollë mirë e organizuar, por diplomat e kësaj shkolle akoma nuk njihet nga universitetet shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Është për tu habitur, diplomat e kësaj shkolle të mesme njihen në shumë shtete si: Turqia, Egjipti, Arabia Saudite, etj., por nuk njihen në shtetin ku graviton kjo shkollë. Medreseja “Isa Beu” përveç pjesëmarrjes nëpër gara ndërkombëtare, njihet edhe për nxjerrjen e kuadrove të dalluar, të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm jo vetëm në fushën teologjike, por edhe në fusha të ndryshme si në politikë, arsim, etj. Duke njohur sfidat me të cilat përballlet ky vend, Bashkësia Fetare Islame forcon mbështetjen e saj për mbrojtjen dhe përkrahjen e

medresesë në të gjitha këndvështrimet. Bashkësia Fetare Islame synon të shfrytëzojë maksimalisht mekanizmat dhe forumet ekzistuese për të çuar përpara akreditimin e medresesë, qoftë përmes negociatave direkte me ministrinë e arsimit apo edhe nëpërmjet partive politike të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në Republikën e Maqedonisë Veriore dhe kanë ndikim në ministrinë e arsimit.

Qëllimet e hulumtimit

Organizimi, menaxhimi apo funksionimi i mirë i shkollave luan një rol të rëndësishëm në procesin mësimorë, po ashtu luan rol edhe në “trekëndëshin” mësues-nxënës-prindër. Të tri këto shtylla janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën dhe luajnë një rol të rëndësishëm thelbësorë për suksesin e reformave edukativo arsimore dhe për krijimin e një ambienti ku nxënësit mund të japin maksimumin e tyre. Një shkollë publike që funksionon mirë sigurisht që udhëheqësit e asaj shkolle janë duke menaxhuar mirë dhe rezultatet e asaj shkolle janë pozitive. Gjithashtu, menaxhimi i mirë ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e nxënësve dhe ua shton vullnetin për të mësuar dhe ngjallë konkurrencë në mesin e nxënësve. Reforma në fushën e arsimit duhet të çojë në përmirësimin e cilësisë dhe të sigurojë një fokus më të madh në nevojat e arsimtarëve dhe nxënësve.

1. Kapitulli I – Definimi dhe përshkrimi i medreseve

1.1 Definimi dhe përshkrimi i medreseve

Definicioni etimologjik i medresesë rrjedh nga fjala arabe medrese (medaris në shumës), që do të thotë thjesht "shkollë". Kurse në aspektin terminologjik, medrese ka për qëllim një institucion arsimor që ofron mësim në temat islame duke përfshirë, Kuranin, thëniet e Profetit Muhamed (hadith), jurisprudencën islame (fikh), etj. Historikisht, medresetë ishin institucione të studimeve të larta dhe dalloheshin nga shkollat që mësonin vetëm Kuranin.¹

Kohëve të fundit, "medreseja" është përdorur si kapëse nga shumë hulumtues orientalist, për të thënë se çdo shkollë fillore, e mesme ose e avancuar promovon një kurrikulë të bazuar në fenë islame. Në shumë vende, duke përfshirë Egjiptin dhe Libanin, fjala medrese i referohet çdo edukimi institucional (i sponsorizuar nga shteti, privat, laik ose fetar). Kurse në Pakistan dhe Bangladesh, termi medrese zakonisht u referohet shkollave fetare islame.² Megjithatë, vendet perëndimore, termi medrese zakonisht u referohet institucioneve specifike islame. Një shkollë tipike islame zakonisht ofron dy kurse studimi: një kurs hifzi; që është mësimi i Kur'anit përmendësh (personi që e mëson përmendësh tërë Kur'anin quhet hafiz); dhe një kurs të ashtuquajtur "alim" që e çon kandidatin për t'u bërë një dijetar i pranuar në komunitet. Një program i rregullt mësimor përfshin kurse në gjuhën arabe, Tefsir (interpretimin e Kuranit), Sheriat (Ligji Islam), Hadith (thënie dhe vepra të regjistruara të Profetit Muhamed) dhe histori islame. Në varësi të kërkesave arsimore, disa medrese ofrojnë edhe kurse shtesë të avancuara në letërsinë arabe , gjuhë angleze dhe gjuhë të tjera të huaja, si dhe shkencë dhe histori botërore. Medresetë osmane së bashku me mësimet fetare mësonin gjithashtu "stilet e të shkruarit, gramatikën, sintaksën, poezinë, kompozimin, shkencat natyrore, shkencat politike dhe etikë".³

¹ Islamic Religious Schools, Madrasas: Background Christopher M. Blanchard Analyst in Middle Eastern Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division. Order Code RS21654 Updated January 23, 2008

² Inside Madrassas Understanding and engaging with British-Muslim faith supplementary schools, Myriam Cherti and Laura Bradley November 2011 © IPPR 2011 report Institute for Public Policy Research faqe. 18.

³ Halil Inalcik: "Learning, the Medrese, and the Ulema." In The Ottoman Empire: The Classical Age 1300–1600. New York: Praeger, 1973, f. 165–178.

1.2 Institucionet arsimore në fillim të Islamit

Përveç thirrjes në fenë islame, Profeti Muhamed ishte i angazhuar edhe në mësimdhënien e Kuranit në Mekke. Veprimtaritë edukativo-arsimore që nisën në Mekkë, shumë shpejtë dhanë frutat e tyre, për një kohë shumë të shkurtër Profeti Muhamed përgatiti disa mësues të Kuranit. Dy vjet para emigrimit të tij në Medine, ai dërgoi një person në këtë qytet për të ua mësuar Kuranin banorëve të Medinës. Kur Profeti Muhamed u shpërngul në Medine në vitin 622, puna e parë që bëri ishte ndërtimi i një xhamie, ku një pjesë e kësaj xhamie u shëndrua në një qendër edukativo-arsimore e cila u emërua "Suffa".⁴ I Dërguari i Zotit ulej në xhami ku përreth tij uleshin edhe shokët e tij (sahabët) duke formuar një lloj hallke, dhe kështu merrnin mësim të ndryshme nga Profeti Muhamed. Me formimin e "hallkave" në xhami, vazhduan edhe katër kalifët e Islamit, pasi kjo mënyrë e mësimi tregojë rezultate të vlefshme, numri i njerëzve shtohet dita-ditës dhe me kalimin e kohës interesimi ishte më i madh.⁵ I njëjti sistem i mësimi vazhdoi edhe gjatë periudhës Emevite (Umajjadët). Ahmed Emin thotë se: *"Nuk kemi njohuri se emevitët kanë themeluar ndonjë medrese. Në atë kohë mësohej nëpër shtëpi dhe xhami"*, thotë ai.⁶

Në periudhat pas shekullit të parë të Hixhrit, shumë dijetarë islam u shpërndajtën gjithandej nëpër xhamia duke i shfrytëzuar ata si shkolla për të mësuar të gjitha llojet e shkencave. Përveç edukimit fetar në xhami, ata mësonin letërsinë, poezinë, historinë, mjekësinë, astronominë dhe degë të shkencës si kozmografia.⁷

Në periudhën e parë të Abasidëve, aktivitetet edukative u zhvillonin në xhami. Gjatë sundimit të kalifit Ma'mun (198-218H./813-833), në vitin 217H./832 u themelua instituti "Bejtu'l-Hikme" në Bagdad. Philip K. Hitti ka thënë për këtë institucion: *"Institucioni i parë i famshëm në Islam në fushën e arsimit të lartë u themelua nga kalifi Me'mun në kryeqytet."*⁸ Bejtu'l-Hikme ishte medreseja e parë. Në të njëjtën periudhë në Bagdad u hapën institucionet "Bejtu'l-ilm" dhe "Daru'l-ilm" qendra mësimore si Bejtu'l Hikme e cila ua kishte përgatitur terrenin.⁹

⁴ Muhammed Hamldullah: İslam Peygamberi, 1980, f.828

⁵ Mehmet Dag & Hivzirrahman R. Öymen: İslam Eğitim Tarihi, Ankara, 1976, f. 118.

⁶ Ahmed Emin: Fecru'l-İslam, çev.: A. Serdaroğlu, Ankara, 1976, f. 253.

⁷ Ahmed Çelebi & Ali Yardım: İslamda Eğitim öğretimi Tarihi, DAMLA YAY, 1998, f. 106-107.

⁸ Hitti, P.K. & Salih Tuğ: İslam Tarihi, BOĞAZİÇİ YAYINLARI, İstanbul, 1980, f. 630.

⁹ Cahid Baltacı: XV-XVI. Asırlarda Osmanlı Medreseleri, İRFAN MATBAASI, İstanbul, 1976, f. 5.

1.3 Historiku i medreseve

Kërkimi i diturisë ka qenë pjesë përbërëse e traditës islame. Në fillim të shpalljes hyjnore dituria mësohej gojarisht. Ashtu siç mësoheshin vargjet e poezisë, njerëzit u frymëzuan që ti mësojnë edhe versetet kuranore përmendësh. Me kalimin e kohës, Islami u zgjerua dhe u bë e nevojshme që të ruhen këto njohuri, versetet kuranore u shkruajtën dhe u përpiluan në kapituj të ndryshëm. Kjo përmbledhje e verseteve është Libri hyjnorë i myslimanëve.

Që herët, Islami theksoi dy lloje të diturisë, njohuritë e reveluara dhe njohuritë e përgjithshme, domethënë njohuri e reveluar që vjen drejtpërdrejt nga Zoti dhe njohuri e përgjithshme që duhet të zbulohet nga vetë qeniet njerëzore. Islami i konsideron të dyja të një rëndësie jetike dhe i urdhëron pasuesit e tij, si burrat ashtu edhe gratë, që të kërkojnë diturinë.¹⁰ Për myslimanët, Kurani është fjala e përsosur e Zotit, e shenjtë dhe për këtë arsye nuk mund të ndryshohet. Është mirë që Kurani të mësohet përmendësh nga fillimi deri në fund. Një person që e ka përvetësuar atë do të mbante njohurinë e Islamit në zemrën e tij/saj dhe do ta përhapte atë tek personat e tjerë. Sipas Islamit, kërkimi i njohurive të përgjithshme është gjithashtu i rëndësishëm sepse njohuritë e përgjithshme e komplementojnë dijen e shpallur nga Zoti në Kuran dhe u ndihmon myslimanëve të jenë produktiv dhe të mirë në këtë botë. Duke kuptuar logjikën e mësipërme, mund të kuptohet pse xhamitë u bënë qendra në proceset mësimore të myslimanëve në ditët e para të Islamit dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë edhe sot e kësaj dite. Ishte Profeti Muhamed që do të mbledhte njerëzit në xhami për të ua kumtuar shpalljet hyjnore dhe interpretimin e tyre.¹¹ Xhamitë ishin vendet ku mësohej Kurani. Aty myslimanët e hershëm që kërkonin t'i zgjidhnin problemet e tyre në dritën e diturisë së re të zbuluar do të vinin për të marrë përgjigje. Xhamia ishte shkolla e parë në Islam. Në ditët e para të Islamit, nuk kishte hierarki dhe çdokush mund të fliste për përmbajtjen e Kuranit mund t'i drejtonte lutjet dhe t'i këshillonte njerëzit. Njerëzit e ditur zakonisht kalonin shumicën e kohës në xhami duke debatuar dhe lustruar njohuritë e tyre për Kurani dhe të tjerët që nuk mund t'i kushtonin shumë kohë këtij aktiviteti, thjesht do të kërkonin ndihmën e tyre në çështjet e jetës së përditshme.

¹⁰ Boyle, Helen, Quranic School Strategy and Mini Needs Assessment, Trip Report to Nigeria, 2002

¹¹ Ahmed, Munir, Islamic Education Prior to the Establishment of Madrassa, Journal of Islamic Studies, 1987.

Pas vdekjes së Profetit, kur myslimanët u përballën me situata për të cilat nuk gjenin përgjigje në Kuran, dijetarët myslimanë kërkuan përgjigje në thëniet dhe jetën praktike të Profetit. Kjo çoi në zhvillimin e traditës të ndjekjes së Sunnetit, njohja e veprave të Profetit dhe thëniet e tij. Xhamia vazhdoi të ishte qendra e mësimi edhe pas vdekjes së Profetit. Ky kuptim dhe përvetësim i njohurive i bazuar në xhami funksionoi shumë mirë për myslimanët e Gadishullit Arabik, sepse traditat fisnore të kombinuara me mësimet e Kuranit ishin të mjaftueshme për të qeverisur jetën e njerëzve që flisnin të njëjtën gjuhë dhe kishin të njëjtin sfond kulturor. Megjithatë, derisa Islami u zgjerua në rajone të tjera dhe ra në kontakt me traditat dhe gjuhët e tjera indigjene, u bë e nevojshme të krijohet një kuadër i ekspertëve myslimanë që do të zhvillonin shkrime dhe tekste të sofistikuar mbi jurisprudencën islame (fikh), traditat e Profetit (veprimtarinë dhe thëniet e Profetit) dhe interpretimin i Kuranit (tefsir), për të plotësuar nevojat e popullatës myslimane jo arabe. Kështu filloi tradita e Medresesë, qendra për arsimin e lartë qëllimi fillestar i së cilës ishte ruajtja e konformitetit fetar përmes mësimave uniforme të Islamit për të gjithë.¹² Qytetërimi i parë islam, në të cilin aktivitetet edukative u formësuan më së shumti rreth faltoreve fetare, u themelua në periudhën e themelimit të medresesë së parë në shek. X gjatë periudhës së dinastisë Karahanite.¹³

Në përgjithësi, historianët islamë pajtohen se organizata e parë institucionale e medresesë është Medreseja Nizamiye e themeluar në Bagdad nga veziri selxhuk Nizam al-Mulk. Kjo nismë konsiderohet gjithashtu si një fillim shumë i rëndësishëm për zhvillimin intelektual dhe shkencor të qytetërimit islam. Struktura organizative, sistematike, programi dhe filozofia ideologjike e këtij institucioni të parë u vlerësuan si modele të medreseve. Në shumicën e qyteteve brenda kufijve natyrorë të qytetërimit islam, në një kohë të shkurtër u krijuan shumë medrese.¹⁴ Ka mendime se medreseja e parë thuhet se është themeluar në vitin 1005 pas Krishtit nga kalifët fatimidë në Egjipt. Kjo medrese mësoi versionin e pakicës shi'ite të Islamit. Ajo kishte të gjitha përbërësit e një institucioni arsimor. Kishte bibliotekë, caktoheshin mësues për lëndë të ndryshme dhe nxënësve që pranoheshin në atë medrese u pajiseshin me ngjyrë, letër dhe stilolaps pa pagesë. Një fakt interesant për këtë medrese

¹² Islamic Education A Brief History of Madrassas With Comments on Curricula and Current Pedagogical Practices By Uzma Anzar, Ph.D. March 2003. f.3.

¹³ Cahit Baltacı: XV.-XVI Yüzyıllarda Osmanlı Medreseleri I, İFAV Yayınları, İstanbul. f. 61

¹⁴ Mustafa Sibai: İslam Medeniyetinden Altın Tablolar, Second Edition, Trans. N. Demircan-M.p. Şimşek, Uysal Kitabevi, Konya, f. 137.

është se një katalog i kësaj medreseje i përgatitur në vitin 1045 zbuloi se ajo kishte 6500 vëllime për lëndë të ndryshme, duke përfshirë astronominë, arkitekturën dhe filozofinë.¹⁵ Kur myslimanët sunitë pushtuan Egjiptin, ata rindërtuan versionin shiit të Islamit në këtë medrese dhe e zëvendësuan atë me versionin Sunit, shkatërruan librat dhe dorëshkrimet që dukeshin në kundërshtim me versionin e tyre të Islamit dhe ruajtën vëllimet që lidheshin me njohuritë e përgjithshme. Një numër i madh librash u dërguan në Bagdad, ku një vezir selxhuk i quajtur Nizam-ul-Mulk Hassan Bin Al-Tusi, themeloi Medresenë e parë të organizuar në vitin 1067.

Në medresenë e re të themeluar nga Nizam-ul-Mulk ofroheshin dy lloje edukimi: teologjia skolastike për të prodhuar udhëheqës shpirtërorë dhe njohuritë e përgjithshme për të prodhuar shërbëtorë të qeverisë që do të emëroheshin në vende dhe rajone të ndryshme të perandorisë islame. Më vonë, Nizam-ul-Mulk krijoi medrese të shumta në të gjithë perandorinë, të cilat përveç ofrimit të njohurive islame ata mundësuan edukimin edhe në fushat e shkencave, filozofisë, administratës publike dhe qeverisjes. Nizam-ul-Mulk konsiderohet të jetë babai i sistemit arsimor publik islam.¹⁶ Është autor i një libri të njohur (ndër myslimanët e hershëm) mbi administratën publike të quajtur "Siyasat Nama".

Edhe pse shumica e medreseve gjatë shekujve të mëpasshëm do të mbetën qendrat e mësimit islam, një numër i madh i tyre nxorën dijetarë dhe filozofë të njohur, të cilët kontribuan gjithashtu në fusha të ndryshme ose laike. Ixhtihadi ishte një tipar i veçantë i këtyre medreseve, ixhtihadi është një përpjekje për të nxjerrë rregulla që zgjidhin problemet, të cilat nuk janë të qarta në Kuran dhe hadithe. Kjo është veçanërisht e vërtetë për medresetë e Spanjës, ku myslimanët sunduan për gati 800 vjet dhe e cila zakonisht quhet epoka e artë e përparimit islam në shkencë dhe filozofi. Pikërisht në Andaluzi, Spanjë, islami thuhet se lindën një numër dijetarësh që ndërthurën njohuritë shpirtërore me njohuritë e përgjithshme dhe kontribuan në ruajtjen e dijes greke dhe evropiane, e cila ishte në prag të zhdukjes. Nën urdhrat e besimit musliman u themeluan medrese edhe në nën kontinentin Indian dhe Azinë Qendrore. Në këto medrese u mësuan gramatika, poezia, letërsia, logjika, matematika dhe disiplina të tjera të Islamit dhe njohuritë e përgjithshme. Meqenëse shumica e njohurive rreth Islamit u regjistruan në arabisht dhe persisht,

¹⁵ Ahmed, Munir, Islamic Education Prior to the Establishment of Madrassa, Journal of Islamic Studies, 1987

¹⁶ Haqqani, Husain, Islam's Medieval Outposts, Foreign Policy Magazine, November 2002

medresetë në nën-kontinentin Indian u bënë vende ku mësohej në gjuhën arabe dhe persishte. Çdo nxënës që aspironte të arrinte nivelin më të lartë të arsimit të medresesë duhej t'i mësonte këto dy gjuhë, pavarësisht nga gjuha amtare e nxënësit. Poetët më të njohur të Indisë në atë kohë, duke huazuar nga sufitradat e Persisë dhe Azisë Qendrore, kompozonin poezitë e tyre në persisht.¹⁷

1.4 Funksionimi i medresesë - qasje e përgjithshme

Edhe pse teorikisht, mund të thuhet se medresetë janë vende ku zhvillohet një veprimtari shkencore në të cilën përqendrimi është në fikh, megjithatë vlen të përmendet se studimet mbi medresetë në botën islame janë shkruar në bazë të dy fushave kryesore të diskutimit. E para nga këto tema të diskutimit është arsyeja pse u krijuan medresetë, dhe e dyta është se cili është funksioni i medreseve. Hulumtimet e para duket se fokusohen më shumë në pyetjen e parë, kurse studimet më të reja në pyetjen e dytë. Pavarësisht se në cilën pyetje përqendrohemi, duhet t'i përgjigjemi pyetjes se deri në çfarë mase medresetë morën një rol qendror në jetën shkencore pas shfaqjes së saj dhe çfarë kuptimi bartë në jetën shkencore. Makdisi është ndër emrat e parë që diskutojnë për pozitën e medreseve në jetën shkencore të botës islame. Makdisi e diskutoi gjerësisht këtë çështje, fillimisht në artikullin e tij të titulluar " Të mësuarit në institucionet myslimane në Bagdadin e shekullit të XIX" dhe më pas në librin e tij "Ngritja e kolegjeve", i cili pati jehonë të madhe në qarqet shkencore. Në veprën në fjalë theksohet fuqishëm se ka filluar një epokë e re në funksionimin e jetës shkencore në botën islame së bashku me medresetë. Sipas Makdisit, medresetë u themeluan për mësimin e fikhut, e cila është shkenca kryesore fetare.¹⁸

Makdisi në veprën e tij ka paraqitur një model statik medreseje që vlen për çdo periudhë dhe çdo vend, konceptet dhe funksionet e së cilës janë përcaktuar saktësisht dhe nuk kanë ndryshuar kurrë.¹⁹ Pikëpamjet e Makdisit për medresenë zënë një vend të

¹⁷ Islamic Education A Brief History of Madrassas With Comments on Curricula and Current Pedagogical Practices By Uzma Anzar, Ph.D. March 2003. p.4.

¹⁸ Përveç kësaj, sipas Makdisit, në kundërshtim me pretendimin e Goldziherit, medreseja në thelb është e lidhur me ligjin islam dhe është një institucion i përkushtuar ndaj mësimin të fikhut. Shkencat e tjera mësoheshin në medrese jo si shkenca, por si shkenca ndihmëse të shkencës së fikhut.

¹⁹ Kur bëhet fjalë për jetën arsimore në botën islame, të gjitha çështjet që lindin mishërohen në përshkrimin e Medresesë nga Makdisi. Në modelin e tij nuk mund të vërehet ndonjë boshllëk që lidhet me medresenë. Themelimi, funksionimi, administrimi, nënpunësit, pagat e nëpunësve, buxhetet e medreseve, lëndët, programet, metodat etj., çdo segment është marrë në konsideratë. Baza e modelit të medresesë që ai vizatoi është gjithmonë shembulli i Medresesë Nizamije të Bagdadit. Ai përpiket t'i shpjegojë gjërat përmes saj sa më

rëndësishëm në studimet e medresesë, por kanë qenë edhe objekt kritikash të ndryshme. Një nga kritikët e para dhe më serioze ndaj Makdisit i përket A. L. Tibawi. Duke kritikuar pikëpamjet e Makdisit për medresenë,²⁰ Tibawi gjithashtu shprehu mendimet e tij për vendin e medresesë në shkencë dhe politikë.²¹ Sipas tij, është e gabuar të tentosh që të paraqesësh një model universal të medresesë, i cili model përcakton të gjithë funksionimin e medresesë.

Goldziher, Pedersen, Makdisi dhe Tibawi përgjithësisht u përqendruan në atë se çfarë ishte medreseja dhe natyra, realiteti i saj. Joan Elizabeth Gilbert, e cila erdhi pas këtyre emrave, u fokusua në ndryshimet në praktikën dhe jetën shkencore të ulemave së bashku me medresetë. Sipas Gilbertit, situata e re që u shfaq me medresetë është profesionalizimi i ulemave në një klasë profesionale dijetarësh. Në fakt, dihet se shumë dijetarë u mbështetën drejtpërdrejt nga sulltanët dhe mbretërit ose përmes fondacioneve gjatë periudhës së “Zengitëve” dhe “Ejubitëve”. Numri i dijetarëve apo kërkuesit të dijes që u mbështetën në këtë mënyrë vetëm gjatë kohës së Salahuddinit është rreth 600. Gilbert e zhvilloi pretendimin e saj mbi shembullin e Damaskut, i cili përfshinte periudhat Selxhuke, Zengite dhe Ejubite, dhe i dha një rol qendror medresesë dhe fondacioneve të ngjashme duke përshkruar linjat e përgjithshme të jetës shkencore.

Shkaqet dhe rezultatet e themelimit dhe funksionit të medreseve në historinë e Islamit mund të ndryshojnë sipas vendit dhe kohës në të cilën janë themeluar ata (medresetë). Prandaj, duhet vënë në pikëpyetje se deri në çfarë mase pretendimet aktuale mund të vlejnë për një vend dhe kohë të caktuar, duhet të përpiqemi të arrijmë në një konkluzion duke vlerësuar dinamikën unike të çdo vendi dhe periudhe. Çfarë nënkuptonin medresetë në Damask në shekujt XII-XIII, duhet të vlerësohet në dritën e pretendimeve ekzistuese dhe gjithashtu duhet të shqyrtohen pavarësisht nga këto pretendime.

shumë që të jetë e mundur. Për këtë arsye Makdisi duket se neglizhon zhvillimin historik dhe diversitetin gjeografik të medresesë.

²⁰ Sipas Tibawit, është e vështirë të argumentohet se medresetë janë vetëm institucione të përkushtuara për mësimin e fikhut, siç pretendon Makdisi. Sepse nuk ka asnjë informacion se profesorët nuk kanë mësuar ndonjë shkencë tjetër përveç fikhut në medrese.

²¹ Sipas Tibawit, Nizam al-Mulk themeloi medresenë Nizamije jo për të mbështetur esharizmin apo shafiizmin, por për të trajnuar kandidatë-njerëz të shtetit dhe kandidat për burokracinë që do të kryenin reformat që ai kreu. Sepse Nizam al-Mulk kishte bërë shumë reforma në fushën e administratës shtetërore. Mbështetja e tij ndaj modelit të medresesë lidhej drejtpërdrejt edhe me këto reforma administrative. Ajo që ai donte ishte të përpiqej të rriste ndikimin e shtetit në fushën politike, ekonomike dhe fetare.

1.5 Femra myslimane dhe arsimimi

Rreth vitit 750, gjatë Kalifatit Abasid, gratë u bënë të njohura për trurin dhe bukurinë e tyre".²² Në veçanti, shumë gra të njohura të asaj kohe u trajnuan që nga fëmijëria me muzikë, vallëzim dhe poezi . Mahbuba ishte një prej tyre. Një figurë tjetër femërore që mbahej mend për arritjet e saj ishte Tawaddud, një skllave për të cilën thuhej se ishte blerë me kosto të madhe nga Harun er-Rashidi, sepse ajo kishte kaluar provimet e saj nga studiuesit më të shquar në astronomi, mjekësi, drejtësi, filozofi, muzikë, histori, gramatikë, letërsi, teologji dhe ishte shahiste e shquar.²³ Për më tepër, ndër figurat më të spikatura femërore ishte Shuhda e cila njihet si "Dijetare" ose "Krenaria e Grave" gjatë shekullit të dymbëdhjetë në Bagdad. Pavarësisht njohjes së prirjeve të grave gjatë dinastisë Abbaside, të gjitha këto morën fund në Irak me plaçkitjen e Bagdadit në vitin 1258.²⁴

Gratë luajtën një rol të rëndësishëm në themelet e shumë institucioneve arsimore islame, të tilla si themelimi i Universitetit el-Karavijin në qytetin Fes në Maroko nga Fatime el- Fihri në vitin 859. Kjo vazhdoi deri në dinastinë ejubide në shek. XII dhe XIII, kur 160 xhami dhe medrese u krijuan në Damask , 26 prej të cilave u financuan nga gratë përmes sistemit të Vakëfit (fondi i bamirësisë). Gjysma e të gjithë patronëve mbretërorë për këto institucione ishin gjithashtu gra.²⁵ Sipas dijetarit Ibn Asakiri në shekullin e XII-të, kishte mundësi për arsimimin e femrave në botën islame mesjetare , duke shkruar se gratë mund të studionin, të fitonin ixhaze (grada akademike) dhe të kualifikoheshin si dijetare dhe mësuese. Ky ishte veçanërisht rasti për familjet intelektuale, të cilat donin të siguronin arsimim sa më të lartë për djemtë dhe vajzat e tyre.²⁶ Ibn Asakiri kishte studiuar vetë nën 80 mësuese të ndryshme në kohën e tij. Edukimi i femrave në botën islame u frymëzua nga gratë e Profetit Muhamed, si Hatixheja, një biznesmenë e suksesshme. Sipas një hadithi që i atribuohet Profetit Muhamed, ai i lavdëroi gratë e Medinës për shkak të dëshirës së tyre për njohuri fetare:²⁷ *"Sa të shkëlqyera ishin gratë e ensarëve; turpi nuk i pengoi ato të bëhen të ditura në çështjet fetare."*

²² Doreen Ingrams: The Awakened: Women in Iraq, London, 1983, f. 22

²³ Po aty, f. 23

²⁴ Anthony Nutting: The Arabs. HOLLYS and CARTER, Cambridge, United Kingdom 1964, f. 196

²⁵ James E. Lindsay: Daily Life in the Medieval Islamic World, Greenwood Publishing Group, 2005, f. 197

²⁶ Po aty, f. 198

²⁷ Po aty, f. 196

Ndonëse nuk ishte e zakonshme që gratë të regjistroheshin si studente në klasat zyrtare, ishte e zakonshme që gratë të merrnin pjesë në ligjërata joformale dhe në sesione studimi në xhami, medrese dhe vende të tjera publike. Gratë përbënin jo më shumë se 1% të dijetarëve islamë para shekullit të XII, pas kësaj pati një rritje të madhe të dijetareve femra. Në shekullin e XV, dijetari Al-Sakhawi i kushton një vëllim të tërë të fjalorit të tij biografik me 12 vëllime "Daw al-lami" studiuesve femra, duke dhënë informacion për 1075 prej tyre.²⁸ Kohët e fundit, studiuesi Mohammad Akram Nadwi, aktualisht një studiues nga Qendra e Oksfordit për Studime Islame, ka shkruar 40 vëllime mbi "muhaddithat" (gratë dijetare të hadithit), dhe ka cekur të paktën 8000 gra.²⁹

1.6 Jeta shoqërore dhe Medreseja

Si me çdo vend tjetër gjatë periudhës së hershme moderne , si Italia dhe Spanja në Evropë, jeta shoqërore osmane ishte gjithashtu e ndërlidhur me medresenë. Medresetë u ndërtuan si pjesë e një kompleksi të xhamive, ku shumë programe, si ndihma për të varfërit përmes kuzhinave nën infrastrukturën e një xhamie, gjë që tregon ndërlidhjen e fesë dhe jetës shoqërore gjatë kësaj periudhe. Xhamitë me të cilat ishin ngjitur medresetë, dominonin jetën shoqërore në qytetet osmane. Jeta shoqërore nuk dominohej nga feja vetëm në botën myslimane të Perandorisë Osmane; megjithatë, ishte gjithashtu mjaft e ngjashme me jetën shoqërore të Evropës gjatë kësaj periudhe. Siç thotë Goffman: "Ashtu si xhamitë dominonin jetën shoqërore për osmanët, kishat dhe sinagogat dominuan jetën për të krishterët dhe hebrenjtë gjithashtu." Prandaj, jeta shoqërore dhe medreseja ishin të lidhura ngushtë, pasi medresetë, siç u përmend më parë, mësonin shumë programe mësimore, si feja, e cila drejtonte jetën shoqërore. Në përgjithësi, fakti që xhamitë përmbanin medresetë tregon rëndësinë e edukimit me fenë në kuptimin që edukimi bëhej brenda kornizës së fesë dhe feja vendosi jetën shoqërore duke u përpjekur të krijonte një ortodoksi të përbashkët fetare. Prandaj, medresetë ishin thjesht pjesë e jetës shoqërore të shoqërisë pasi studentët erdhën për të mësuar bazat e vlerave dhe besimeve të tyre shoqërore.³⁰

²⁸ Guity Nashat & Lois Beck: Women in Iran from the Rise of Islam to 1800, University of Illinois Press, 2003, f.69

²⁹ A Secret History, By Carla Power Feb. 25, 2007 www.nytimes.com

³⁰ Daniel Goffman: The Ottoman Empire and Early Modern Europe. United Kingdom: U of Cambridge, 2002

1.7 Faktorët socio-ekonomikë

Medresetë ofrojnë arsim, shkollim falas për studentët e tyre, dhe kështu ata ua mundësojnë shkollimin familjeve dhe individëve të varfër. Në tërësi, këto shkolla fetare mbështeten nga donacione private nga besimtarët myslimanë përmes një procesi të dhënies së lëmoshës ose zekatit. Praktika e zekatit - një nga pesë shtyllat e besimit islam - parashikon që një pjesë fikse e të ardhurave të dikujt të jepet për qëllime të caktuara bamirëse, dhe tradicionalisht një pjesë e zekatit jepet për edukim fetar. Pothuajse të gjitha medresetë janë të destinuara për edukimin e meshkujve, edhe pse në disa vende janë një numër i vogël i medreseve për femra.³¹

1.8 Kurrikula e medreseve

Përmbajtja e kurrikulës kontribuon ndjeshëm në ndikimin e mendjes së nxënësve. Praktikant pedagogjike gjithmonë kanë siguruar faktin që nxënësi duhet të arrijë rezultatin e synuar të nxënësve për të bërë përparim të mëtijshëm në marrjen e njohurive.

Siç u përmend më parë, feja dominonte më shumë nga njohuritë dhe mësimet që u ishin dhënë nxënësve. "Mësimi fetar si e vetmja shkencë e vërtetë, qëllimi i vetëm i së cilës ishte të kuptuarit e fjalës së Zotit".³² Prandaj, është e rëndësishme të mbahet parasysh ky impuls kur shikojmë programin mësimor që është mësuar.

Sipas Halil Inalcik këto ishin lëndët që mësoheshin nëpër medrese:

a) Shkencat kaligrafike - të tilla si stilet e të shkruarit.

b) Shkencat linguistike - si gjuha arabe , gramatika dhe sintaksa.

c) Shkenca intelektuale - logjika në filozofinë islame.

d) Shkencat shpirtërore - teorike, si teologjia dhe matematika islame; dhe praktike, siç është etika dhe politika islame.³³

³¹ Islamic Religious Schools, Madrasas: Background Christopher M. Blanchard, Analyst in Middle Eastern Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division Order Code RS21654 Updated January 23, 2008.

³² Halil Inalcik: "Learning, the Medrese, and the Ulema." In The Ottoman Empire: The Classical Age 1300–1600. New York: Praeger, 1973, f. 165–178.

³³ Po aty, f. 178

Edhe pse në disa medrese jepen lëndë laike, në përgjithësi në medrese ofrojnë një kurrikulë të bazuar në fe, duke u fokusuar në Kuran dhe tekste islame. Përtej udhëzimeve në parimet themelore fetare, disa argumentojnë se një grup i vogël i medreseve të radikalizuara, të cilat ndodhen pranë kufirit Afganistan-Pakistan, promovojnë një formë të Islamit militant dhe mësojnë nxënësit e tyre musliman të luftojnë jobesimtarët dhe të qëndrojnë kundër shthurjeve morale të Perëndimit.³⁴ Hulumtuesit e tjerë sugjerojnë se këto shkolla janë krejtësisht të pa krahasuara me studimet fetare dhe janë të fokusuara vetëm në mësimdhënie dhune.³⁵ Sidoqoftë, disa medrese me kalimin e kohës kanë evoluar, nga qendra të mëimit islam kanë përvetësuar edhe njohuritë laike në kurrikulën e tyre. Vetëm medresetë në Pakistan dhe disa pjesë të Indonezisë janë munduar të ruajnë kurrikulat tradicionale të medreseve, pra vetëm lëndët fetare, kurse të tjerat janë përpjekur të mbajnë një ekuilibër në mësimdhënien e lëndëve fetare dhe laike (Egjipt, Bangladesh, etj.). Megjithatë, gjithnjë e më shumë, disa Ulema (dijetar musliman) theksojnë se dituria laike duhet të shpjegohet në dritën e njohurive të shpallura në Kuran.

Struktura dhe procedurat operative të medreseve ndryshojnë nga rajoni në rajon. Në Afrikën Perëndimore, shumica e mëimit islam zhvillohet në mektebe (shkolla kuranore). Ka vetëm disa medrese në Afrikën Perëndimore ku nxënësit marrin arsim të detajuar islam. Në botën arabe, qeveritë financojnë shumicën e medreseve, kontrollojnë kurrikulën dhe sigurojnë që disa lëndë laike të mësohen në këto institucione. Në Indonezi dhe Malajzi, qeveritë ndjekin pak a shumë të njëjtin model si në botën arabe. Në rajonin e Azisë Jugore, një numër i madh medresesh, megjithëse financohen nga bordet e veçanta të edukimit fetar që funksionojnë nën Ministrinë e Çështjeve Fetare, janë të lira të marrin fonde të tjera nga donatorë privatë. Kurrikula e përbashkët në medrese, në të gjitha rajonet, janë studimet islame dhe përvetësimi i të kuptuarit të parimeve islame që drejtojnë jetën e përditshme të muslimanëve. Prandaj, lëndët si: Fikhu - Jurisprudenca islame, Hadithi - Thëniet dhe traditat

³⁴ Husain Haqqani, "Islam's Medieval Outposts," Foreign Policy no. 133, Nov./Dec. 2002; Anna Kuchment et al., "School by the Book," Newsweek, Mar. 11, 2002.

³⁵ Disa shkrimtarë kanë lënë të kuptohet se të gjitha medresetë janë porta të militantizmit. Shih, për shembull, Jessica Stern, "Preparing for a War on Terrorism," Current History 100, no. 649 (2001): 355-357; and Alan Richards "At War with Utopian Fanatics," Middle East Policy 8, no. 4 (2001).

profetike, Tefsiri - interpretimi i Kuranit dhe logjika përbëjnë thelbin e kurrikulës së medresesë.³⁶

1.9 Medresetë nëpër botë

Medreseja e parë osmane u themelua në İznik në vitin 1331 dhe shumica e medreseve osmane ndoqën traditat e islamit sunit. Kur një sulltan osman themelonte një medrese të re, ai do të ftonte dijetarë nga bota islame. Murati II solli studiues nga Persia, të cilët ndihmuan në rritjen e reputacionit të Medresesë osmane. Kjo tregon se bota islame ishte e ndërlidhur në periudhën e hershme moderne dhe ata udhëtonin në shtetet e tjera islame duke shkëmbyer njohuritë e tyre. İnalçık gjithashtu përmend se derisa studiuesit nga Persia udhëtuan te osmanët për të ndarë njohuritë e tyre, osmanët udhëtuan gjithashtu për të marrë dituri nga studiues të këtyre vendeve islame, si Egjipti, Persia dhe Turkestani. Prandaj, kjo tregon se ngjashëm me botën e sotme moderne, individë nga shoqëria e hershme moderne udhëtonin jashtë vendit për të marrë dituri dhe për të shkëmbyer njohuri dhe se bota ishte më e ndërlidhur nga sa duket. Gjithashtu, tregon se si sistemi i "shkollimit" ishte gjithashtu i ngjashëm me botën e sotme moderne ku studentët udhëtojnë jashtë vendit në vende të ndryshme për studime. Shembuj të medreseve osmane janë ato të ndërtuara nga Mehmet Fatihu. Ai ndërtoi tetë medrese në të dyja anët e xhamisë, të cilat i përgatitnin nxënësit për tetë medrese të larta për studime të specializuara. Fakti që ato janë ndërtuar rreth, apo afër xhamive, zbulon impulset fetare pas ndërtimit të medresesë dhe zbulon ndërlidhjen ndërmjet institucioneve të mësimit dhe fesë. Kjo tregon se ngjashëm me sistemin arsimor sot, sistemi arsimor i osmanëve përfshinte lloje të ndryshme shkollash të lidhura me lloje të ndryshme nivelesh.³⁷

Megjithëse medresetë osmane kishin një sërë degësh të ndryshme studimi, si shkencat kaligrafike, shkencat intelektuale, ato kryesisht i shërbenin funksionit të një qendre islame për mësimin shpirtëror. Të përmendura shpesh nga kritikët se medresetë nuk përfshinin një shumëllojshmëri të shkencave natyrore gjatë kohës së Perandorisë Osmane, medresetë përfshinin programe mësimore që përfshinin një gamë të gjerë shkencash natyrore. Kishte shumë dijetarë, matematikanë dhe shkencëtarë të njohur musliman të cilët

³⁶ Islamic Education A Brief History of Madrassas With Comments on Curricula and Current Pedagogical Practices By Uzma Anzar, Ph.D. March 2003 f. 6-7

³⁷ Halil İnalçık: "Learning, the Medrese, and the Ulema." In The Ottoman Empire: The Classical Age 1300–1600. New York: Praeger, 1973, f. 165–178.

u angazhuan për të mësuar fëmijët e familjeve më të dalluara në shoqëri.³⁸ Dihej se qëllimi i të gjitha njohurive dhe në veçanti, i shkencave shpirtërore është njohja e Zotit. Feja, në pjesën më të madhe, përcakton domethënien dhe rëndësinë e secilës shkencë. Megjithatë, edhe pse matematika, ose studimet logjike ishin pjesë e kurrikulës së medresesë, të gjitha ishin të ndërlidhura kryesisht me fenë. İnalçık gjithashtu përmend se edhe filozofia lejohej të studiohej vetëm në mënyrë që të ndihmonte në konfirmimin e doktrinaeve të Islamit. Prandaj, medresetë - shkollat ishin kryesisht qendra për mësimet fetare në botën osmane.³⁹

Megjithëse studiues të tillë si Goffman kanë argumentuar se osmanët ishin shumë tolerantë dhe jetonin në një shoqëri pluraliste, duket se shkollat që ishin qendrat kryesore të mësuarit ishin në fakt shumë fetare dhe nuk ishin fetarisht pluraliste, por më tepër me natyrë islame.⁴⁰ Kështu, medresetë osmane ishin shumë të ngjashme me shkollat e sotme në kuptimin që ato ofronin një gamë të gjerë studimesh; megjithatë, këto studime, në objektivin e tyre përfundimtar, synonin të forconin dhe konsolidonin më tej praktikën dhe teoritë islame. Në vitin 1924, presidenti i parë, Mustafa Kemal Atatürk, zëvendësoi medresetë me shkollat jofetare të bazuara në një model arsimor përfundimtar ose i shndërroi ato në shkollat të quajtura Imam Hatib për trajnimin e predikuesve myslimanë. Megjithatë, kur presidenti Erdogan mori pushtetin në vitin 2002, ai dhe partia e tij i shndërruan shkollat Imam Hatib në shkollat të mesme dhe të mesme fetare, të diplomuarit e të cilave mund të aplikonin në çdo program universitar. Midis viteve 2003 dhe 2012, regjistrimet në shkollat Imam Hatib u trefishuan. Pesëmbëdhjetë vjet më parë kishte 450 shkollat të tilla, sot janë 4500.⁴¹

Sa i përket Azisë jugore, Afganistani që nga fillimi i vitit 2021, kishte rreth 5000 medrese të regjistruara në Ministrinë e Çështjeve Fetare (të paregjistruara nuk dihet numri), rreth 250 vetëm në Kabul, duke përfshirë medresenë Darul-Ulum Imam Ebu Hanife e cila ka 200 arsimtarë dhe 3000 nxënës. Rreth 380,000 nxënës janë regjistruar në këto medrese të njohura nga qeveria, prej tyre duke përfshirë 55,000 vajza.⁴² Në Bangladesh ekzistojnë tre

³⁸ Sonja Brentjes: Teaching and Learning the Sciences in Islamic Societies (800-1700). Turnhout, Belgium: BREPOLs, 2018, f. 77–111.

³⁹ Halil İnalçık: "Learning, the Medrese, and the Ulema." In The Ottoman Empire: The Classical Age 1300–1600. New York: Praeger, 1973, f. 165–178.

⁴⁰ Daniel Goffman: The Ottoman Empire and Early Modern Europe. United Kingdom: University of Cambridge Press, 2002.

⁴¹ Myriam Renaud, Ph.D. Candidate in Religious Thought and Ethics, University of Chicago, 2017.

⁴² Zahra Rahimi: "Govt Plans to Bring Madrassas Under State Control". TOLONews (8 January 2021).

sisteme të ndryshme arsimore të medreseve: sistemi origjinal nizami, sistemi i ri dizajnuar nizami dhe plan programi më i lartë alia nisab. Dy kategoritë e para zakonisht quhen Kaumi ose medrese popullore.⁴³ Midis tyre, më të shquara janë medreseja në Hathazari, medreseja në Patiya dhe medreseja në Sylhet. Në vitin 2006 kishte 15,000 medrese Kaumi të regjistruara në Ministrinë e Arsimit të Bangladeshit, edhe pse shifra mund të ishte mbi dyfishin e këtij numri nëse numëroheshin medresetë e paregjistruara.⁴⁴ Medresetë e rregulluara nga qeveria nëpërmjet Ministrisë së Arsimit të Bangladeshit quhen medresetë Alia dhe numërojnë rreth 7000, duke ofruar, përveç mësimin fetar, lëndë të tilla si anglishtja dhe shkenca, dhe të diplomuarit e saj shpesh e përfundojnë arsimin e tyre në institucione laike. Sa që rreth 32% e profesorëve të universiteteve në shkencat humane dhe shoqërore janë të diplomuar në këto medrese Alia.⁴⁵

Në Indi, ka rreth 30,000 medrese që funksionojnë. Shumica e këtyre shkollave ndjekin doktrinën hanefite. Institucioni fetar është pjesë e dy divizioneve kryesisht të mëdha brenda vendit, përkatësisht Deoband, të cilët dominojnë në numër (Darul Ulum Deoband është një nga medresetë më të mëdha në botë) dhe Bareilvi, të cilët gjithashtu përbëjnë një pjesë të konsiderueshme (të orientimit sufi). Darul Ulum Deoband, konsiderohet si medreseja më e njohur në Azi, ndodhet në Uttar Pradesh. Ministria e Burimeve Njerëzore e Qeverisë së Indisë, ka deklaruar se do të ngrihet një Bord Qendror i Medresesë. Kjo do të përmirësojë sistemin arsimor të Medreseve në Indi. Megjithëse medresetë japin kryesisht edukim Kuranor, po bëhen përpjekje për të përfshirë matematikën, informatikën dhe shkencën në kurrikulë.⁴⁶

Në Pakistan, nganjëherë spekulohet se prindërit i dërgojnë fëmijët e tyre në medrese për shkak të pamundësisë për të përballuar kostot e larta të arsimit. Megjithëse medresetë janë falas, ato ofrojnë arsim adekuat për nxënësit e tyre. Nganjëherë spekulohet se për shkak të cilësisë së ulët të arsimit ata që mbarojnë e kanë të vështirë të gjejnë punë.⁴⁷

⁴³ Siddiqi, ABM Saiful Islam "Madrasah". In Islam, Sirajul; Jamal, Ahmed A. (eds.). *Banglapedia: National Encyclopedia of Bangladesh* (Second ed.). Asiatic Society of Bangladesh. 2012

⁴⁴ "Qawmi madrasahs under watch". *The Daily Star*. 2009-03-31.

⁴⁵ Tahmima Anam: "An education: Inside Bangladesh's madrasahs". *The Guardian*. (20 May 2011).

⁴⁶ Padmaja Nair: *The State and Madrasahs in India*. Working Paper. University of Birmingham, Birmingham, UK, (2009), f. 18

⁴⁷ Christine Fair: "The Enduring Madrasah Myth". 2012, *Current History*. 111 (744): 135–140.

Përlllogaritjet e numrit të medreseve varrojnë nga 12,000 deri në 40,000. Edhe pse Pakistani ka më shumë medrese, numri është ende në rritje në shumë vende të ndryshme.⁴⁸

Nepali ka 907 medrese të njohura në të njëjtin nivel me shkollat shtetërore, por numri i përgjithshëm në vend është rreth 4000.⁴⁹

Në Azinë Juglindore, studentët myslimanë janë të lirë të zgjedhin për të ndjekur një shkollë laike ose një shkollë islame. Medresetë ose shkollat islame njihen si Sekolah Agama në Malajzi, Indonezi dhe Tajlandë. Numri i medreseve në Indonezi është më shumë se dyfishuar nga viti 2002/2003 në 2011/2012, duke shkuar nga 63,000 në 145,000, medresetë e panjohura përbëjnë 17% të gjitha shkollave në vend, ndërsa medresetë e njohura përbëjnë gati 1/3 e shkollave të mesme.⁵⁰

Në Singapor, medresetë janë shkolla private të cilat mbikëqyren nga Majlis Ugama Islam Singapura (MUIS, Këshilli Fetar Islamik i Singaporit). Ka gjashtë Medrese në Singapor, që u shërbejnë nxënësve nga shkolla fillore deri në të mesme. Katër medrese janë për të dy gjinitë dhe dy janë vetëm për vajza.⁵¹ Nxënësit kanë një sërë lëndësh të Studimeve Islame, përveç lëndëve të zakonshme të kurrikulës së shkollave shtetërore. Nxënësit që dëshirojnë të ndjekin një shkollë të zakonshme mund të zgjedhin të marrin mësim në fundjavë në medrese në vend që të regjistrohen me kohë të plotë.

Në Filipine sipas një Raporti Ndërkombëtar të Lirisë Fetare të Departamentit Amerikan të Shtetit të vitit 2006, vendi ka pasur rreth 2000 medrese, ku gjysma e tyre ndodhen në Mindanao.⁵² Në vitin 2004, medresetë u përfshinë në 16 rajone në mbarë vendin, kryesisht në zonat me shumicë myslimane në Mindanao nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit. Që nga viti 2005, Ministria e Arsimit ka ndihmuar një grup medresesh private që kërkojnë një leje nga qeveria për të vepruar.⁵³

⁴⁸ Kamila Hyat: "No room for doubt and division". The News International. Archived from the original on 4 September 2009. Retrieved 25 September 2008.

⁴⁹ Arjun Rajbanshi: "A madrasa blends traditional education with modern to keep up with the changing times". The Kathmandu Post. (27/10/2019).

⁵⁰ Asadullah M Niaz "Poor Indonesian families are more likely to send their daughters to cheap Islamic schools". The Conversation. (6 March 2020).

⁵¹ "Background of Madrasahs". muis.gov.sg. 1994. Archived from the original on 2015-04-02. Retrieved 2015-03-18.

⁵² Mogato Manny: "Catholic Philippines teaches Islam in state schools". Reuters. (21 March 2007).

⁵³ "BARMM to grant special eligibility for Madaris teachers in new education code". BARMM Official Website. Bangsamoro Information Office. 2021-05-19. Retrieved 19 May 2021.

Në Afrikën veriperëndimore (Magrib), duke përfshirë Marokun , Algjerinë dhe Tunizinë , shfaqja e medreseve u vonua, ajo filloi të lulëzojë në rajon vetëm në shekullin e XIII, nën dinastitë Marinide dhe Hafside. Në Tunizi, medreseja më e hershme hafside ishte Medreseja el-Ma'rad, e themeluar në Tunis në vitin 1252 dhe e ndjekur nga shumë të tjera.⁵⁴ Në Maroko, medreseja e parë ishte Medreseja es-Saffarin e ndërtuar në Fes në vitin 1271, e ndjekur nga shumë të tjera të ndërtuara në mbarë vendin.⁵⁵ Marinidët ndërtuan gjithashtu medrese në Algjeri, veçanërisht në Tlemcen.⁵⁶

Medresetë shërbyen për të trajnuar dijetarët dhe elitat e arsimuara që në përgjithësi drejtonin burokracinë shtetërore.⁵⁷ Gjithashtu një rol mbështetës luajtën edhe xhamtë, Universiteti i vjetër el-Karavijin dhe Xhamia el-Andalusijja (të dyja të vendosura në Fes) sepse ato siguronin strehim për nxënësit që vinin nga qytete të tjera. Shumë nga këta nxënës ishin të varfër, duke kërkuar dije për të fituar një pozitë më të lartë në qytetet e tyre të lindjes, dhe medresetë u siguronin atyre gjërat e nevojshme si banesa dhe ushqimi.⁵⁸ Megjithatë, medresetë ishin gjithashtu institucione mësimore më vete dhe ofronin kurset e tyre, por zakonisht me programe mësimore shumë më të ngushta dhe më të kufizuara se sa shkollat e tjera. Medreseja Bou Inania në Fes, u dallua nga medresetë e tjera për nga madhësia e saj dhe duke qenë e vetmja medrese që funksiononte zyrtarisht edhe si xhami publike e së Premtes.⁵⁹ Disa medrese historike në Maroko mbetën në përdorim deri në shekullin e XX, shumica nuk përdoren më për qëllimin e tyre origjinal pas riorganizimit të sistemit arsimor maroken nën sundimin kolonial francez dhe në periudhën pas pavarësisë të

⁵⁴ Pedersen, J.; Makdisi, G.; Rahman, Munibur; Hillenbrand, R. "Madrasa". Encyclopaedia of Islam, Second Edition. Brill. (2012).

⁵⁵ Kubisch Natascha: "Maghreb - Architecture" in Hattstein, Markus and Delius, Peter (eds.) Islam: Art and Architecture. (2011)

⁵⁶ Binous Jamila; Baklouti Naceur; Ben Tanfous Aziza; Bouteraa Kadri; Rammah Mourad; Zouari Ali (2002). Ifriqiya: Thirteen Centuries of Art and Architecture in Tunisia (2nd ed.). Museum With No Frontiers, MWNF.

⁵⁷ Lintz Yannick; Déléry Claire; Tuil Leonetti Bulle: Maroc médiéval: Un empire de l'Afrique à l'Espagne. Paris: Louvre éditions. (2014).

⁵⁸ Parker Richard: A practical guide to Islamic Monuments in Morocco. Charlottesville, VA: The Baraka Press. (1981)

⁵⁹ Robert Irwin: Ibn Khaldun: An Intellectual Biography. Princeton University Press. 2019. f. 29–30.

vitit 1956.⁶⁰ Po kështu në Tunizi disa medrese përdoren ende për të mësuar, shumë prej tyre janë kthyer në përdorime të tjera në kohët moderne.⁶¹

2. Kapitulli II – Organizimi dhe Funksionimi i medresesë në RMV

2.1 Arsimimi në Maqedoni

Gjatë kohës së mesjetës në Evropë dituria ishte pothuajse e humbur dhe nuk gjendej përpos në disa vende. Besojë se çdo njeri sado pak i arsimuar e di realitetin në të cilin gjendej Evropa mesjetare. Gjendja e Evropës mesjetare karakterizohej me injorancë, prapambeturi, padrejtësi dhe jetesë e aristokratëve në kurrizin e skllëvërve. Në kohën kur bota islame kishte hapëruar në shumë këndvështrime, edukimi perëndimor, i cili ishte nën sundimin e kishës, nuk interesohej për asgjë përpos anës shpirtërore që manifestohej përmes disa ritualeve fetare. Në Shqipëri dhe Maqedoni institucionet arsimore mesjetare ishin shumë të pakta si shkak i mungesës të ndonjë aktivitetit arsimor dhe për shkak të luftërave të njëpasnjëshme dhe ndërrimit të qeverive. Sistemi arsimor në këto vende përqendrohej vetëm në shkrim-lexim për nevojat e kishës, por ishte një privilegj të shkollohesh pasi nuk iu mundësohej çdo njerit, ishte privilegj vetëm për familjarët e klerikëve ose shtresës aristokrate.

Në shekullin X u formuan disa qendra për përhapjen e krishterimit dhe të dogmave fetare në mesin e njerëzve. Më e dalluara ishte peshkopata e Ohrit e cila njihet si një ndër peshkopatat më të rëndësishme në Maqedoni, qofshin ato shqiptare apo joshqiptare. Kjo ndikonte në përhapjen e kulturës greko-bizantine dhe asaj sllave.⁶² Në Maqedoni para se të depërtonte perandoria osmane gjuha e arsimit ishte gjuha latine, greke dhe sllave, gjuha latine përdorej nga kisha katolike kurse gjuha greke dhe sllave nga kisha ortodokse. Perandoria osmane, gjatë shekujve XV dhe XVI i dha rëndësi të madhe arsimit në të gjitha kategoritë: arsimit të ulët, të mesëm si dhe të lartë. Arsimimi i popullatës myslimane arrihej në institucionet arsimore të quajtura mektebe dhe medrese.⁶³

⁶⁰ Parker, Richard (1981). A practical guide to Islamic Monuments in Morocco. Charlottesville, VA: The Baraka Press. (1981)

⁶¹ Binous Jamila; Baklouti Naceur; Ben Tanfous Aziza; Bouteraa, Kadri; Rammah, Mourad; Zouari, Ali: Ifriqiya: Thirteen Centuries of Art and Architecture in Tunisia. Islamic Art in the Mediterranean. Museum With No Frontiers & Ministry of Culture, the National Institute of Heritage, Tunis. (2010).

⁶² Musli Bajrami, Periudha historike e Medresesë së Isa Beut, Gostivar, 2005, f. 27

⁶³ Dr. S. Rizaj, Historia e përgjithshme, Prishtinë, 1985, f. 67

Në Maqedoni, gjatë periudhës së parë osmane, angazhimi i shtetit për arsim ka qenë tejet i vogël, ngase njerëzit ishin të lirë që të vendosin vetë për çështjen e arsimit, të arsimohen apo jo. Gjatë shek. XV dhe XVI hulumtimet rreth arsimit në Maqedoni pothuajse janë të humbura, nuk kemi burime historike që e sqarojnë çështjen e arsimit në atë kohë, me përjashtim të vakëf nameve të gjetura nga Glisha Elezoviq dhe Hasan Kaleshi. Këta dy studiues kanë gjetur nga disa vakëf name, shumica në gjuhën arabe, sepse kjo gjuhë ishte edhe gjuhë administrative në dy shekujt e parë të shtetit osman, por ka pasur të shkruara edhe në gjuhën osmane. Të gjitha këto vakëf name janë të përkthyer në gjuhën serbokroate nga vetë autorët e përmendur. Në asnjë shoqëri vakëfi nuk ka luajtur rol të rëndësishëm si në fenë islame. Nëse u kthehemi vakëf nameve të gjetura nga Glisha Elezoviq dhe Hasan Kaleshi shohim se shumica e të dhënave që ata i ofrojnë, burojnë nga disa personalitete me pozita të larta në shtetin osman, e ndër më të njohurit në sferën e arsimit ishte Isa beu i biri i Is'hak beut, që është edhe themelues i medresesë së njohur me emrin e tij.⁶⁴

2.2 Sibjan-mektebet

Fjala sibjan-mekteb rrjedh nga fjala turke që do të thotë: shkollë e fëmijëve. Kjo lloj shkolle në të kaluarën ka qenë tipi më i ulët i shkollave fetare islame për fëmijët, djem e vajza. Në këto shkolla në të shumtën e rasteve si mësues shërbenin imamët e xhamive përkatëse. Këto lloj shkollash hapeshin nëpër qytete, por nuk mungonin as nëpër fshatra, qëllimi kryesorë ishte që fëmijët musliman të edukoheshin në frymën fetare. Në sibjan-mektebe mësohej leximi i Kur'anit, shkrimi arab, Ilmihali (dituritë themelore për shkencat islame), e në disa vende edhe libra të tjerë fetarë.

Sibjan-mektebet u themeluan që nga shekujt VII-VIII. Pastaj, me përhapjen e islamit, këto shkolla u bartën nga Arabia në vendet e Azisë së Mesme, e më pas, sidomos me fuqizimin e Perandorisë Osmane, u përhapën edhe në disa vende të Evropës. Në vendin tonë këto shkolla deri në vitin 1912 ishin nën administratën e Perandorisë Osmane.⁶⁵ Në kohën e Mbretërisë serbo-kroato-slovene, tek muslimanët e këtyre vendeve vepruan disa sibjan-mektebe, mirëpo nuk gjetën rehati nga qarqet qeveritare të asaj kohe. Deri në vitin

⁶⁴ Musli Bajrami, Periudha historike e Medresesë së Isa Beut, Gostivar, 2005, f. 30

⁶⁵ Akademik Jasar Redzepagic, Razvoj i obelezja turski skola na teritoriji danasnje Jugoslavije do 1912 godine. "Studije" Pristina, 1988, f.52.

1929/30 numri i sibjan-mektebeve ka qenë shumë i vogël. Shumica kanë punuar me vetë iniciativën e disa hoxhallarëve, kurse në vitin 1931-32 numri i sibjan-mektebeve fillon të rritet.⁶⁶ Popullata myslimane tregon interes më të madh rreth interesimit të shkollimit të fëmijëve të tyre e sidomos të angazhimit në sibjan-mektebet ku numri i tyre filloi të rritej vazhdimisht. Nëpër fshatrat malore ka pasur një ngecje në edukimin nëpër sibjan-mektebe për shkak të kushteve të vështira, kurse nëpër qytete ku ishin kushtet më të përshtatshme, gati në çdo vend ka pasur nga një mekteb.⁶⁷

2.3 Medresetë në Maqedoni

Është e vështirë të përcaktohet saktësisht hapja e medreseve të para në Maqedoni, për shkak të mungesës së argumenteve, por duke u mbështetur në vakëf namet ekzistuese konstatohet se medresetë e para janë hapur përafërsisht në të njëjtën kohë me themelimin dhe hapjen e xhamive të para në Maqedoni, edhe pse ato janë hapur pak para medreseve. Rreth vitit 1397 është themelimi i xhamive në Maqedoni. Xhamia e Jegit Beut, çliruesit të Shkupit është xhamia e parë që është themeluar në këto troje. Jegit Beu thuhet se kishte ndërtuar edhe një medrese pranë xhamisë së tij. Kjo shkollë ka funksionuar deri në luftën e dytë botërore, pastaj u shkatërrua nga gjermanët. Aktualisht nuk ka mbetur asnjë lloj gjurme e xhamisë dhe medresesë përveç varrit të Jegit Beut dhe Medah babës. Osmanlinjtë themeluan medrese në çdo qytet të Maqedonisë. Nga medresetë më të njohura në Maqedoni gjatë periudhës së osmanlinjve ishin, medreseja e Senkur Çaušh Beut dhe Medreseja Is'hak Çelebi në Manastir. Kurse medresetë më të njohura në Shkup ishin medreseja e sulltan Muratit e ndërtuar në vitin 1438 dhe Medreseja e Is'hak Beut e quajtur Is'hakije. Pastaj Medreseja Isa Beu e ndërtuar në vitin 1469 nga biri i Is'hak Beut, Isa Beu. Nga Medresetë tjera të themeluara në Shkup është edhe medreseja Mustaf Pasha dhe medreseja Jahja Pasha. Ndërtimi i medreseve në Ballkan nuk u bënte nga pushteti osman, por nga personalitete të njohura në pushtetin osman. Pas largimit të osmanlinjve nga Ballkani, numri i medreseve në Ballkan filloi që gradualisht të zvogëlohet. Pas vitit 1945 në Maqedoni pushteti komunist i mbylli të gjitha medresetë.⁶⁸

⁶⁶ Shinazi Memedi, Objektet fetaro islame dhe vakëfet në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918-1941, Bashkësia Fetare Islame në RM, Shkup, 2017. f. 80

⁶⁷ Po aty, f.88

⁶⁸ Mr. Taxhedin Bislimi, Vakëfi në Maqedoni 1391-2001, Muftinia BI – Shkup, 2007 f. 198

Tabela në vijim sqaron numrin e medreseve që ekzistonin gjatë shekullit XVII, duke u mbështetur në të dhënat e Evlija Çelebiut.⁶⁹

Emri i qytetit	Numri i medreseve deri vitin 1660	Numri i medreseve deri vitin 1912	Numri i medreseve mes viteve 1920-1940	Numri i medreseve pas vitit 1945
<i>Shkupi</i>	Më shumë se 5 medrese	5	3	1
<i>Kumanova</i>	1	1	1	0
<i>Kërçovë</i>	0	1	0	0
<i>Koçan</i>	0	1	0	0
<i>Radovich</i>	1	1	0	0
<i>Strugë</i>	1	0	0	0
<i>Manastir</i>	9	9	0	0
<i>Ohër</i>	2	0	1	0
<i>Veles</i>	2	4	0	0
<i>Resën</i>	1	0	0	0
<i>Kavadarcë</i>	1	0	0	0
<i>Dibër</i>	0	10	0	0
<i>Strumicë</i>	Disa medrese	0	0	0
<i>Prilep</i>	Disa medrese	5	1	0
<i>Tetovë</i>	0	0	5	0
<i>Gostivar</i>	0	0	1	0
<i>Shtip</i>	1	3	0	0
<i>Dojran</i>	Disa medrese	0	0	0
<i>Kratovë</i>	1	1	0	0
<i>Gjithsej</i>	Më shumë se 25	49	12	1

Edhe pas mbylljes së medreseve në vitin 1945 në Maqedoni, dijetarët islam vazhduan që në forma të ndryshme të mbajnë gjallë mësim besimin.

2.4 Historiku i medresesë “Isa Beu”

Medreseja e parë që u ndërtua në Shkup është ajo e Isa Beut në vitin 1469 nga Gazi Isa Beu. Kjo medrese që nga themelimi e deri më sot ka pushuar së punuari disa herë për shkak se godina e sajë u shkartua nga luftërat dhe fatkeqësitë. Në vitin 1689 kur generali Austriak Pikolomini me ushtrinë e tij e dogji qytetin e Shkupit, kjo medrese pushoi për herë të parë me aktivitetet e saj. Pas rënies së Perandorisë Osmane dhe ndryshimit të kartës

⁶⁹ Mr. Taxhedin Bislmi, Vakëfi në Maqedoni 1391-2001, Muftinia BI – Shkup, 2007 f. 199

politike në këto troje edhe zhvillimi i arsimit-medreseve pësoi një stagnim të gjatë kohor, por me iniciativën e prijësve fetar dhe intelektualëve të atëhershëm në vitin 1932 kjo medrese përsëri u rindertua. Në vitin shkollor 1936-1937 rihapet përsëri medreseja e Isa Beut e cila ishte si mostër për medresetë e tjera me programin e saj të reformuar. Programin që ndoqi ishte ai i medresesë Gazi Husrev Beut në Sarajevë me disa ndryshime nga ana Këshillit në Shkup, program ky i cili ishte treguar i mirë, progresiv dhe i suksesshëm. Medreseja e re me këtë Plan-program merr karakterin e shkollës fetare ku do të përgatiten arsimtarë të mirëfilltë fetarë.⁷⁰

Më 2 Tetor të vitit 1936 pas tre shekujve, medreseja Isa Beu rihapet përsëri dhe vazhdon aktivitetet e saja në një ndërtesë të re moderne, krahas xhamisë të ndërtuar nga Isa Beu. Kjo shkollë kishte rangun e plotë të shkollës së mesme. Parashihej që nxënësit e kësaj medreseje të vazhdojnë studimet në fakultet teologjike Islame. Shkolla ishte e tipi të internatit. Në mbarim të vitit shkollor 1939-40 në medrese kishte 145 nxënës.⁷¹ Më 6 Prill të vitit 1941 kjo medrese ndërpreu aktivitetet e saja si shkak i luftës së dytë botërore. Pas luftës së dytë botërore deri në vitin 1979 përsëri pushoi, derisa Bashkësia Fetare Islame solli vendimin për rindërtimin e saj. Pas shumë peripecish objekti i ri u ndertua në f. Kondovë dhe në vitin shkollor 1984-85 filloi procesi edukativo-arsimor.⁷²

2.5 Gazi Isa Beu

Gazi Isa Beu ishte i biri i Gazi Is'hak Beut dhe nipi i Pashë Jegit Beut, çliruesit dhe komandantit të parë për Shkupin dhe rrethin e tij, kurse Gazi Isa Beu, nipi i tij ishte komandanti i tretë i rrethit të Shkupit. Gazi Isa Beu në këtë post pasoi gjyshin (Jegit Beun) dhe babin e tij (Is'hak beun) në periudhën e sundimit të Sultan Muratit të II-të (1421-1451) dhe të birit të tij Sultan Fatih Mehmetit të II-të (1451-1481). Gazi Isa Beu konsiderohet njëri nga personalitetet më të shquara të shekullit XV në trojet e Ballkanit. Sa i përket datëlindjes së tij dhe datës kur ka nduar jetë, për fat të keq nuk ka informacione. Hulumtuesi Muhamed Muhedinovic mendon se varri i tij është afër "Careva Xhamia" në Sarajevë.⁷³ Sa i

⁷⁰ Shinazi Memedi, Objektet fetaro islame dhe vakëfet në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918-1941, Bashkësia Fetare Islame në RM, Shkup, 2017. f.92

⁷¹ Musli Bajrami, Periudha historike e Medresës së Isa Beut, Shkup, 2005, f.96

⁷² Shinazi Memedi, Objektet fetaro islame dhe vakëfet në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918-1941, Bashkësia Fetare Islame në RM, Shkup, 2017. f.92

⁷³ Lidija Kumbaradži-Bogoević, Osmanliski spomenici vo Skopje, Islamska zaednica vo RM-Skopje, Sektor za Nauka i Islamska Kultura, Skopje, 1998. f. 48

përket veprimtarisë së tij në Ballkan, të dhënat historike shënojnë veprimtari të ndryshme ne do t'i përmendim vetëm disa më kryesore. Gazi Isa Beu në vitin 1439 caktohet guvernator i Prishtinës dhe në këtë post ai qëndroi pesë vite. Më pas, në vitin 1448 gjatë luftës mes Hungarisë dhe Perandorisë Osmane ai zëvendësoi të atin e tij (Is'hak Beun) në pozitën e valiut të Shkupit. Në vitin 1454 Gazi Isa Beu emërohet guvernator i Bosnjës me kryeqendër në Sarajevë, ku i ati i tij që nga viti 1436 Sarajevën e kishte zgjedh për rezidencë të tij. Gazi Isa Beu ishte komandant rajonal i tërë Slavonisë, e pastaj u emërua si Sanxhak Bej i saj, kjo nënkuptohet nga një ferman i firmosur nga Sulltan Mehmeti i II-të, që ia kishte drejtuar në vitin 1468.⁷⁴

Sa i përket bamirësisë Gazi Isa Beu njihej si njeri shumë bujar. Nga Vakëfnamja e Gazi Isa Beut në lidhje me vakëfin e Shkupit kuptohet se ai në këtë nënqiell kishte ngritur një Medrese dhe Hanika (teqe), për mirëmbajtjen e tyre kishte lënë vakëf disa pasuri. Fshatin Kuçevisht dhe Draçevë (afër Shkupit) e që ishin pronë e tij personale, 3 çiflige, 2 kopshte brenda në Shkup, 1 çiftë hamam (për burra dhe për gra) e që ekziston edhe sot e kësaj dite në qendër të çarshisë së vjetër të Shkupit dhe një hamam në Tetovë. Poashtu ai ka lënë vakëf më shumë se 10 mullinj, mbi 100 shitore, 15 dhoma, 1 arë për mbjelljen e orizit, e shumë pasuri të tjera. Në bazë të Vakëfnames së Isa Beut të gjithë këto pasuri ai i ka lënë për mirëmbajtjen e Medresesë dhe Hanikas (teques) së tij. Nuk përmend xhaminë e tij sepse sipas mbishkrimit, i cili gjendet mbi portën e hyrjes së xhamisë, xhamia është ndërtua pas vdekjes së tij, por me porosinë e tij.⁷⁵ Isa Beu përkrah medresesë dhe hanikas kishte lënë vakëf edhe një bibliotekë e cila pa dyshim ishte njëra nga bibliotekat më të mëdha në Ballkan gjatë shekullit XV-të. Ai la vakëf 230 tituj në 320 vëllime nga sfera e lëmi të ndryshme. Kjo bibliotekë me tërë këtë fond librash pas dy shekujsh (220 vjet) në vitin 1689 u djeg nga Pikolomini, për veç një librit, të cilin e gjeti Glisha Elezoviç në medresenë e Isa Beut gjatë viteve 30-ta të shekullit XX-të, në faqen e tij të parë shkruante: "Këtë libër të ndershëm e vakëfoi babai i bamirësirave (Ebul-Hajrat), lartësuesi i milletit dhe fesë, Isa Beu i biri i Is'hak Beut, për medresenë që ndertoi në brendi të Shkupit."⁷⁶

⁷⁴ Glasnik islamske Vjerske Zajednice, Kraljevine Jugoslavije, broj 1, Sarajevo, januar 1937, f. 27

⁷⁵ Lidija Kumbaradži-Bogoević, Osmanliski spomenici vo Skopje, Islamska zaednica vo RM-Skopje, Sektor za Nauka i Islamska Kultura, Skopje, 1998. f. 52

⁷⁶ Naser Ramadani, Depërtimi Osman në Maqedoni dhe zhvillimi i arsimit Islam gjatë shekujve IX-X h. (XV-XVI), f. 140

2.6 Medreseja “Isa Beu” pas vitit 1984 dhe shtrirja e saj fizike

Ideja dhe dëshira e muslimanëve në Maqedoni për të patur një medrese ishte e madhe, por në atë periudhë ishte e vështirë që të merren hapa konkret për shkak të sistemit komunist i cili ishte kundër. Shpesh herë mes punëtorve të Bashkësisë Islame flitej për krijimin e një vatre arsimore islame. Në vitin 1976 pas zgjedhjeve që u bënë brenda Bashkësisë Islame, organet e reja dolën me projektin e ndërtimit të medresesë. Mirëpo, problemi kryesor ishte sigurimi i mjeteve financiare. Burimet financiare zeqati dhe sadakatul fitri ishin nga popullata, por ata ishin të destinuara për aktivitetet e tjera të Bashkësisë Islame. Në vitin 1977 pas një mbledhje të mbajtur në Prishtinë nga përfaqësuesit më të lartë në organet e Bashkësisë Islame, Bashkësia Islame del me një projekt konkret për ndërtimin e medresesë. Menjëherë u drejtohet oganeve përkatëse shtetërore për tu siguruar një lokacion për ndërtimin e një shkolle të mesme teologjike. Në këtë projekt parashihej riaktivizimi i medresesë Isa Beu, e cila me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, më konkretisht me 6 Prill 1941 ndërpret aktivitetet e saja. Në fillim lokacioni për ndërtimin e kësaj medreseje Bashkësia Islame e Maqedonisë e kishte paraparë në Saraj të Shkupit, aty afer xhamisë së vjetër. Punët filluan të komplikohen kur erdhi në pyetje projekti i objektit, për arsye se aty u desht të rënohen disa shtëpi për realizimin e projektit, përreth kishte godina të reja dhe disa ishin shtëpi maqedonase që nuk ishte e lehtë të mirren për medrese. Bashkësia Islame hoqi dorë nga ky lokacion, ngase pritej të të pengohej kjo iniciativë dhe të rriten çmimet e shtëpive shumëfish kur ta kuptojnë se është në pyetje një shkollë fetare islame.

Bashkësia Islame kërkon një lokacion tjetër, Kryetari i komisionit për çështje fetare ofronte një vend në Draçevë, mirëpo ky vend përveç që ishte shumë i vogël nuk ishte aspak komod lokacioni, për shkak se ishte i papërshtatshëm për muslimanët të cilët banonin shumica në Maqedoninë perendimore. Procedura u zvarrit gati një vit duke kërkuar vende të lira për ndërtim, pasi vendet në atë kohë ishin të nacionalizuara, dhe kështu më në fund ra propozimi që medreseja të ndërtohet në fshatin Kondovë të Shkupit, konkretisht në vendin ku sot gjendet FSHI-ja (Fakulteti i Shkencave Islame). Qellimi kryesor i pushtetit të atëhershëm ishte që ajo të ndërtohet jasht Shkupit në periferi. Bashkësia Islame nuk pranonduke e pa si vend jo të përshtatshëm, kërkon vendin ku ajo gjendet sot e kësaj dite.

Ky vend në fillim ishte i vogël, por me blerjen e disa vendeve për rreth ai vend u zgjerua po aq sa e parashohin normat pedagogjike, arsimore.

Pas shumë mundimeve, me 2 gusht të vitit 1982 (17 Ramazan), u vendos gurthemeli në fshatin Kondovë, në afërsi të Shkupit. Në fillim kjo medrese mbante emrin “Skopska Medresa” (Medreseja e Shkupit) për arsye se organet e shtetit nuk lejonin të mbante emrin e medresesë së vjetër Isa Beu, me pretekst se ka mbaruar koha e bejlerve. Me 31.05.1982, merret leja për ndërtim, dhe fillon ndërtimi i godinës. Popullata muslimane në Maqedoni u mobilizua, me një vullnet të jashtëzakonshëm ndihmoi medresenë deri në përfundimin e saj.⁷⁷ Financues të këtij projekti gjigant ishin muslimanët e këtij vendi, edhe pse nuk posedonin ndonjë standart të lartë jetësorë, ata kontribuan në maksimum për ndërtimin e medresesë, shumë gra nga qafa e tyre hoqën arin e tyre zbukurues për t’ia falur medresesë. Qëllimi për të pasur një medrese në Maqedoni u realizua, me vetë kontributin e muslimanëve. Muslimanët e Maqedonisë vazhduan edhe ta mirëmbanin medresenë, ku shpenzimet vjetore silleshin prej 900.000 deri 1.000.000 marka gjermane.⁷⁸ Me 15 tetor 1984, në këtë shkollë zilja do ti thërras nxënësit për herë të parë pas katër dekadave ndërprerje. Medresenë e shpalli të hapur Reis-ul-ulema Haxhi Naim Haxhiabdiq, i përcjellë me tekbiere salavate dhe ilahi.⁷⁹ Medreseja Isa Beu konsiderohet shkollë e mesme Islame katër vjeçare, ku planprogramin e saj arsimorë e zhvillon në bazë të parimeve të shkollës juridike Hanefij, duke respektuar edhe shkollat e tjera juridike islame. Krahas objektivit të shkollës ajo posedon edhe objektet e banimit-konviktin ku nxënësit janë të obliguar të banojnë në të. Pastaj kanë edhe restorantin ku ushqehen nxënësit si dhe objektet tjera si biblioteka dhe objektet e rekreacioneve. Kjo shkollë në sajë të rezultateve të saja të shkëlqyera, arriti që shumë shpejtë të theyeje të gjitha barrierat dhe kufijtë duke u shëndruar në një qendër edukativo arsimore islame në nivel Ballkanik, ngase në gjirin e saj kishte nxënës nga të gjitha trevat e Ballkanit si nga Shqipëria, Kosova, Mali i zi, Serbia dhe Bulgaria, kurse diplomat e saja u njohën nga të gjitha Universitetet islamike në botë. Krahas nxënësve të rregullt në këtë vatrë edukativo-arsimore mësimet i kanë ndjekur edhe një numër i nxënësve me korrespondencë, sidomos nga gjinia femërore.⁸⁰ Medreseja me ndërtesat

⁷⁷ Musli Bajrami, Periudha historike e Medresesë së Isa Beut, Gostivar, 2005, f. 120

⁷⁸ Mr. Taxhedin Bislimi, Vakëfi në Maqedoni 1391-2001, Muftinia BI – Shkup, 2007 f. 201

⁷⁹ Musli Bajrami, Periudha historike e Medresesë së Isa Beut, Gostivar, 2005, f. 120

⁸⁰ Mr. Taxhedin Bislimi, Vakëfi në Maqedoni 1391-2001, Muftinia BI – Shkup, 2007 f. 202

përreth, përfshinë sipërfaqe prej 7000m² duke mos llogaritur paralelet e shtrira të saj. Kompleksi i Medresesë përbëhet prej godinës shkollore, konviktit dhe kuzhinës me restorantin.

Në vitin shkollor 2021/22 numri i përgjithshëm i nxënësve që janë regjistruar në Medresenë “Isa Beu” është 461 nxënës. Kështu që, në shkollën qendrore 121 nxënës, në paralelen e vajzave në Shkup 133 nxënës, në paralelen e vajzave në Tetovë 101 dhe atë të vajzave në Gostivar 64, ndërsa në paralen e djemve në Shtip 42 nxënës. Gjithashtu edhe një numër i konsiderueshëm i të interesuarve vijojnë mësimet me korenspondencë, sidomos ajo e gjinisë femrore numri i të cilave arrinë mbi 300 nxënës të çrregulltë. Medreseja “Isa Beu” që nga fillimi ka pasur mësimdhënës me përgatitje përkatëse profesionale. Për lëndët fetare të cilat nuk kishin fond të plotë ligjeronin të punësuarit në BI. Ndërsa sot për përgatitjen profesionale të nxënësve plan-programin mësimor në të gjitha paralelet, duke përfshirë ato rajonale në Tetovë, Shkup , Shtip dhe Gostivar e realizojnë 83 profesorë në marrëdhënie të rregullt pune dhe 9 me kontratë në vepër dhe honorar. Numri i mësimdhënësve gjithësej është 92 profesor. Ka edhe një numër të konsiderueshëm të personelit teknik të cilët përkujdesen për mirëmbajtjen e godinës së shkollës, konviktit, kuzhinës etj. Numri i të cilëve sillet afro 24 të punësuar.⁸¹ Shkollimi në Medrese është gratis. Të gjitha harxhimet i bartë Bashkësia Fetare Islame e RM dhe për 1 (një) nxënës në vit harxhimet llogariten afro 340 EURO. Numri prej 800 medresantëve e medresanteve që aktualisht mësojnë në bankat e kësaj vatre edukative arsimore dhe mbi 3.117 të diplomuarve deri më tani, prej të cilëve 1.469 janë femra, flet qartë se ky institucion është në nivelin më të lartë të detyrës së shenjtë.⁸²

2.6.1 Paralelja e djemve – Shkup



Paralelja e djemve në Shkup, ndyshe njihet si paralelja qendrore e cila funksionon prej vitit 1984. Në këtë paralele mësimi zhvillohet

e-per-fuqizimin-e-fjales-se-allahut/

vetëm për meshkujt. Nxënësit janë të vendosur në internat. Në godinën e shkollës qendrore gjenden tetë mësojtore, dy kabinete të gjuhëve, kabineti i lëndës së informatikës, mesxhidi, biblioteka dhe zyrat e administrates, kurse konvikti ka 53 dhoma me kapacitet për 214 nxënës. Në vitin shkollor 2021/22 mësimin e ndjekin 122 nxënës nga të gjitha trojet e Maqedonisë dhe jasht, në katër vite, me tetë klasa. Planprogrami mësimor realizohet përmes 25 profesorëve, përfshirë këtu edhe drejtorin, zv.drejtorin, sekretarin dhe bibliotekistin. Në vitin shkollor 2021/22 Medresesja do të nxjerë gjeneratën e XXXV.⁸³ Deri më tani kanë diplomuar 1971 nxënës. Kompleksi i medresesë në qendër është i ndarë në: objekti i shkollës, internati, dhe restoranti. Edhe pse dy godinat e fundit janë të ndara nga objekti i shkollës, por që të gjitha janë në një rrethojë.

Objekti i shkollës është dy katëshe. Në katin e parë janë 4 klasa, korridori i cili është shumë i gjërë, mesxhidi për faljen e pesë kohëve të namazit në mënyrë të organizuar, kafiterinë, skriptarinë e cila përvec dispencave për nxënësit mbanë edhe literaturë tjetër për shitje, dhe 5 zyre administrative që janë: zyra e drejtorit, sekretarit, punëdrejtuesit, arkatrit dhe kontabilistit. Në fund të koridorit është abdes'hanja dhe WC.⁸⁴ Biblioteka e nxënësve është mjaft e pasur me tituj librash dhe për momentin numëron mbi 4000 tituj me afro 8000 ekzemplarë në gjuhë të ndryshme. Poashtu seksioni i grupit letrar zakonisht brenda vitit shkollor boton dy numra të gazetës së nxënësve me titullin "Ikre" – lexo.⁸⁵ Objekti katër katësh i cili është i ndarë nga shkolla është internati, në të cilin qëndrojnë nxënësit gjatë javës. Ky objekt ka kapacitet për 216 shtretër. Krahës dhomave të fjetjes ekzistojnë edhe paradržomat ku nxënësit mbajnë rrobet e tyre personale. Për nxënësit që dëshirojnë të mësojnë pas orarit të mësimiit çdo katë ka nga një dhomë për aktivitete. Ndërsa në katin e posandërtuar të katërt gjindet mesxhidi, dhoma të mysafyrve, dhomë të edukatorve dhe kafiteri. Vlenë të theksohet se tërë kompleksi i shkollës posedon nxemjen qendrore i cili është i instaluar në podrumin e konviktit. Gjithashtu në kovikt është edhe bunkeri i pajisur me filter për ajrosje, dhe me dalje të veçantë. Brenda posedon shtretër dhe karrike, të cilët shërbejnë për rast lufte. Në internat gjendet edhe dhoma e edukatorit. Poashtu në të është

⁸³ <https://medreseja-isabeu.com/medreseja-isa-beu-dhe-paralet-e-saja/qender/>

⁸⁴ <https://medreseja-isabeu.com/reth-medreses/>

⁸⁵ Prof. Bahri Aliu, Medreseja Isa Beu vatër e arsimimit dhe e edukimit të gjeneratave të dikurshme, të sotme dhe të nesërme, (Referat i lexuar në Konferencën ndërkombëtare në Tiranë e organizuar nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC) dhe Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) respektivisht Tivar të Malit të Zi, tetor 2016. <https://bahrialiu.com/wp-content/uploads/2019/10/MEDRESEJA-ISA-BEU-VAT%C3%8BR-E-ARSIMIMIT-DHE-E-EDUKIMIT.pdf>

e instaluar edhe ambulanca e cila e në vete ka tri dhoma përfshirë këtu edhe dhomën e kontrollimit mjekësorë ka kapacitet për stacionim prej dhjetë shtretërve. Medreseja në qendër posedon edhe restorantin e vet, i cili ka kapacitet për 150 nxënës, kurse është i ndarë në dy pjesë: pjesa e kuzhinës, e cila është pajisur me mjete të nevojshme për përgatitjen e ushqimit, dhe restoranti ku nxënësit dhe të punësuarit marrin ushqimin. Në kuadër të restoranit është edhe depoja për ruajtjen e artikujve ushqimor e pajisur me frigurifer të mëdhenj. Poashtu në kuadër të restoranit funksionon edhe furra për përgatitjen dhe pjekjen e bukës e cila punon ekskluzivisht për nevojat e Medresesë. Nga kjo nënkuptohet se ky objekt i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret bashkëkohore për funksionimin e tij. Kompleksi i medresesë në qendër është i rrethuar me parkun e saj të bukur me pemë të shumta dhe lule të ndryshme që shtojnë bukurinë natyrore të shkollës.⁸⁶

2.6.2 Paralelja e vajzave – Tetovë



Në Medresenë “Isa Beu” edukimi i femrës zë një vend të rëndësishëm, si dëshmi janë integrimi dhe përfshirja e saj në radhët e medresesë si nxënëse me korrespondencë. Bashkësia Fetare Islame e RMV me kalimin e kohës dhe me krijimin e kushteve realizon në

praktikë një ëndërr të kahmotshme dhe në vitin shkollor 2004/05 hapet paralelja e vajzave me mësim të rregullt në Tetovë. Ndërsa në vitin shkollor 2007/08 diplomoi edhe gjenerata e parë në këtë paralele. Në vitinshkollor 2021/22 diplomon edhe gjenerata XV e kësaj paralele. Numri i përgjithshëm i vajzave që shkollohen me mësim të rregullt në këtë paralele arrin në 101 nxënëse. Bashkësia Fetare Islame duke pasur parasysh që objekti i mëparshëm nuk i plotësonte kushtet për zhvillimin e procesit të mirëfilltë edukativo-arsimor, në vitin shkollor 2007/08 e vuri edhe gurëthemelin e parë për ndërtimin e objektit të ri për këtë paralele. Nxënëset e kësaj paralele vitin shkollor 2009/10 e kanë filluar në objektin e ri,

⁸⁶ <https://medreseja-isabeu.com/reth-medreses/>

hapja solemne e të cilit u bë më 31 tetor 2009. Në këtë paralele deri me tani kanë diplomuar 588 nxënës.⁸⁷ Profesoresha Barie Shabani është përgjegjëse e kësaj paralelje.⁸⁸

2.6.3. Paralelja e djemve – Shtip



Pas hapjes së paraleles së vajzave në Tetovë, Bashkësia Fetare Islame e RMV vendos që të hap paralelen e rradhës të Medresesë “Isa Beu” në Shtip. Në vitin shkollor 2005/06 fillon me mësim të rregullt paralelja e djemve në këtë qytet.

Është një koincidencë e bukur që objekti ri i medresesë i cili gjendet në Shtip, është ndërtuar në vendin e medresesë “Hamidije” të cilën e kishte ndërtuar Sulltan Abdylhamidi II në vitin 1903/4. Ndërtimin e këtij objekti, përveç ndihmës së BFI-së, ndihmë të madhe ka dhënë edhe Prof. Dr. Sabahattin Zaim, i lindur në Shtip, në një shtëpi diku afër objektit të Medresesë, i cili me familjen e tij në moshën tetëvjeçare ishte detyruar të shpërngulet në Turqi. Profesor Zaimi, ka ndihmuar në gjetjen e donatorëve, madje ai, edhe pse i shtyrë në moshë, do të marrë pjesë edhe në vënien e gurthemelit të Medresesë. Ndërtesa e Medresesë, e cila gjendet në qendër të Shtipit, ka katër klasë mësimi, konvikt me kapacitet për 80 nxënës, mensë, bibliotekë, mesxhid dhe zyra administrative - të gjitha me pajisje moderne dhe kushte të volitshme për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor. Duhet theksuar se kjo paralele mbështetjen financiare, që nga hapja e saj, ia ofron partneri i BFI-së nga Turqia “Hudaji Vakfi”.⁸⁹

Në vitin shkollor 2021/22 numri përgjithshëm i nxënësve që shkollohen në këtë paralele arrin në 42 nxënës. Për dallim nga paralelet tjera të medresesë, në këtë paralele mësimi zhvillohet në gjuhën turke dhe në gjuhën maqedone. Në vitin shkollor 2021/2022 në

⁸⁷ Ibrahim Idrizi, Hëna e Re nr. 336, shtator 2019 f, 30

⁸⁸ <https://bfi.mk/dega-e-vajzave-ne-tetove/>

⁸⁹ Mr. Nasir Rexhepi Myfti i Myftinisë së Shtipit, Hëna e Re nr. 336, shtator 2019 f, 42

këtë paralele diplomon gjenerata XIV. Në këtë paralele deri më tani kanë diplomuar 184 nxënës.⁹⁰

2.6.4. Paralelja e vajzave – Shkup



Paralelja e vajzave – Shkup në kuadër të medresesë “Isa Beu” u hap në vitin 2006. Fati i kësaj gjenerate ishte që ata të regjistrohen të rregullta në Medrese. Por fati ishte edhe i profesoreshave të cilat kishin mbaruar Medresenë të çrregullta, që të jenë ligjëruese me mësim të rregullt.⁹¹

Bashkësisë Fetare Islame mori vendim që në vitin shkollor 2006/07 të hapet paralelja e vajzave me mësim të rregullt në Shkup. Ndërsa prej vitit shkollor 2009/2010, duke parë interesimin e madh të kandidateve për t’u regjistruar në këtë paralele, Bashkësia Fetare Islame bën pranimin e dy klasëve në vitin e parë, ndërsa në vitin shkollor 2016/17 pranohen tri klasë në vitin e parë. Numri i përgjithshëm në katër vitet për vitin shkollor 2021/22 arrin numrin e 133 nxënëseve. Paralelja e vajzave në Shkup procesin edukativo-arsimor e zhvillojnë në objektin e Kapan-Hanit. Bashkësia Fetare Islame mendojmë se në të ardhmen, edhe për këtë paralele, sikurse të asaj në Tetovë dhe Gostivar, do të vëjë gurthemelin e një objekti të ri dhe në këtë mënyrë do të mund të plotësohen të gjitha kërkesat e të interesuarëve për t’u regjistruar në këtë vatër arsimore. Në vitin shkollor 2021/2022 Paralelja e vajzave në Shkup nxjerr gjeneratën XIII të maturanteve. Në këtë paralele deri më tani kanë diplomuar 523 nxënëse. Përgjegjëse e kësaj paraleleje është prof. Nurten Shehu - Saqipi.⁹²

2.6.5. Paralelja e vajzave – Gostivar



Në vitin shkollor 2008/09 Bashkësia Fetare Islame, duke e pa të

⁹⁰ Ibrahim Idrizi, Hëna e Re nr. 336, shtator 2019 f. 30

⁹¹ Nurten Shehu Saqipi, Hëna e Re nr. 336, shtator 2019 f. 40

⁹² <https://bll.mk/dega-e-vajzave-ne-shkup/>

nevojshme edukimin e femrës në frymën islame, hap edhe paralelen e tretë me radhë të vajzave në Gostivar. Në fillim regjistrohen vetëm 20 nxënëse, ndërsa nga viti shkollor 2009/10 dhe këndej në këtë paralele u pranuan nga dy klasë. Në vitin shkollor 2021/22 dega e shtrirë e vajzave në Gostivar nxorri gjeneratën XI të femrave dhe me këtë kjo paralele shënon përmbajtjen, kujtimin dhe momentin e pashlyeshëm në ndërtimin e vetëdijes fetare të femrës në shoqëri. Me 18.04.2014 Bashkësia Fetare Islame vuri gurthemelin për ndërtimin e objektit të ri të kësaj paraleleje. Në vitin shkollor 2018/19 nxënëset e kësaj paralele u vendosën në objektin e ri, hapja e të cilit u bë në mënyrë solemne me 27.09.2018. Numri i përgjithshëm në katër vitet për vitin shkollor 2021/22 arrin numrin e 64 nxënësve. Në këtë paralele deri më tani kanë diplomuar 309 nxënëse.⁹³ Përgjegjëse e kësaj paraleleje është prof. Muzeqete Hebibi.⁹⁴

3. Kapitulli III – Menaxhimi i medresesë “Isa Beu”

3.1 Çështjet juridike, organizative dhe financiare të Medresesë “Isa Beu”

Sfidat me të cilat përballlet medresja sot janë të ndryshme. Pas ndryshimeve shoqëro-politike, Medreseja përballlet me etnocentrizmin e vet sipas së cilës e ka shumë vështirë të del jash kornizave autoritative. Medreseja e ka të pamundshme që të bëjë reforma interne, sepse autoritetet e Bashkësisë Islame si themelues të medrsesë, kanë frikën mos vallë do të humbasin prezencën e tyre për të mos thënë influencën e tyre që kanë në Medrese. Çështjen juridike të Medresesë akoma nuk janë të rregulluara, fatkeqësisht sot e kësaj dite nuk e ka të rregulluar çështjen juridike të statusit të saj. Edhe pse nuk varet nga medreseja por nxënësit janë ata që hasin vështirësi gjatë regjistrimit në universitete. Pra, Ministria e Arsimit duhet të marrë një vendim se çfarë do të ndodhë me fatin e medresantëve, të regjistrohen në universitet apo jo. Një pjesë e fajit bukur e mirë i mbetet edhe politikës, e cila kurrë nuk ka shprehur vullnet të mirë për akreditimin e medresesë “Isa BEU”. Sa i përket çështjes organizative, edhe pse Medreseja posedon organet udhëheqëse sipas akteve normative të Bashkësisë Islame, ajo vazhdon të punojë nën presione të natyrave të ndryshme. Ai i cili ka ndikim vendim marrës, është kreu i

⁹³ Ibrahim Idrizi, Hëna e Re nr. 336, shtator 2019 f, 30

⁹⁴ <https://bfi.mk/dega-e-vajzave-ne-gostivar/>

Bashkësisë Islame edhe për çështjet më të imta të punës së medresesë, si p.sh.: pranimi i nxënësve në medrese edhe pse me këtë shkelen Rregulloret e Medresesë; poashtu ai ndikon në punësimin e kuadrit arsimor bëhet nën terkon e afërsisë, aktivitetet që duhet të zhvillojë medreseja kryesisht duhet të miratohen nga kreu i Bashkësisë Islame, pastaj medreseja mund të realizojë aktivitetin që e parasheh akti normativ, Statuti apo Rregullorja.

Për çështjet finansiare, buxhetin e Medresesë e cakton Bashkësia Fetare Islame. Edhe pasi përcakton buxhetin, nuk e lë medresenë të lirë që të veprojë brenda kornizave dhe nevojave të veta, por për çdo imtësi duhet të merret leje nga kreu i Bashkësisë Islame. Medreseja ka bordin e saj drejtues, por nuk mund të veprojë lirshëm, pasi ardhmëria e tyre varet nga piramida e Bashkësisë Islame e nuk varet nga rezultatet e punës së tyre.⁹⁵

3.2 Rregullorja e medresesë “Isa Beu”

Medreseja “Isa Beu” posedon rregulloren e vet, ketu do të veçojmë disa nene të kësaj rregulloreje, siç janë:

Neni 1

Medreseja do të funksionojë me të njëjtat rregulla të Medresesë së mesme të Gazi Husref Beut në Sarajevë. Kjo shkollë prej tash e tutje do të mban emrin Medreseja Qendrore e Reformuar e Gazi Isa Beut.

Neni 2

Kjo Medrese është autonome, shkollë e mesme profesionale teologjike islame, ka karakterin e shkollës së lartë dhe të ulët, ku mësimi zgjatë nga 4 vjet.

Neni 3

Kjo medrese do të finansohet me mjetet e Bashkësisë Islame në Shkup.

Neni 4

⁹⁵ Prof. Bahri Aliu, Medreseja Isa Beu vatër e arsimimit dhe e edukimit të gjeneratave të dikurshme, të sotme dhe të nesërme, (Referat i lexuar në Konferencën ndërkombëtare në Tiranë e organizuar nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC) dhe Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) respektivisht Tivar të Malit të Zi, tetor 2016. <https://bahrialiu.com/wp-content/uploads/2019/10/MEDRESEJA-ISA-BEU-VAT%C3%8BR-E-ARSIMIMIT-DHE-E-EDUKIMIT.pdf>

Mbikqyrës suprem i kësaj medreseje është "Vakuvsko Mearifski Sabor", kurse mbikqyrës i drejtpërdrejtë i mësimit dhe edukimit në të është Ulema Mexhlisi në Shkup.

Neni 5

Në këtë shkollë mësohen këto lëndë: Kiraet (Kur'an), Tefsir, Hadith, Akaid, Fik'h, Ahlak, Histori Islame, Pedagogji, Gj. Arabe, Gj. Turke, Gj. Serbokroate, Gjeografi, Matematikë, Dituri natyrore, Qeverisje, Fizikë, Kimi, Pastërti, Gj. Gjermane ose Gj. Frenge, Shkenca qytetare, Administratë e imamëve, Bukurshkrim (Husnihat), Edukatë Figurative (Vizatim) dhe Edukatë Fizike.

Neni 6

Gjuha Shtetërore është gjuhë zyrtare e Medresesë.

Neni 7

Planprogrami i saj është ai i Gazi Husref Beut në Sarajevë pasi ta miratojë Këshilli i Naibit për Bashkësinë Islame në Shkup.

Neni 8

Lëndët fetare i zhvillojnë profesorët, që kanë kryer:

- a. Darul Fununin (Fakultetin Teologjik).
- b. Xhamiatul Ez'herin.
- c. Akademinë e Sheriatit në Sarajevë.
- d. Shkollën juridike në Sarajevë.
- e. Medresenë e Madhe të Mbretit Aleksandër I, Shkup.
- f. Medresenë me Ixhazet dhe janë teologë e pedagogë të njonur.

Lëndët laike i zhvillojnë profesorët që kanë përgatitje profesionale sipas kushteve të parapara në ligjet për arsim të mesëm.

Neni 9

Në forumin e profesorëve bëjnë pjesë: Drejtori, profesorët e rregullt dhe ata me honorarë.

Neni 10

Këta nënpunës mund të inkuadrohen e të shkarkohen nga puna vetëm me dekretin e Pleqërisë së Vakfit në Shkup.⁹⁶

3.3 Planprogrami i SHMI Medreseja “Isa Beu”

Planprogrami mësimor i SHMI Medreseja “Isa Beu” është unik për të gjitha paralelet. Sipas Plan-programit për katër vite nxënësit mësojnë gjithsej 30 lëndë. Plan-programi për lëndët fetare është i miratuar nga Riaseti i BFI, me propozim të këshillit edukativo arsimor. Planprogrami rishqyrtohet tërësisht në çdo katër vite, kurse analizat i bëhen për çdo vit. Gjuha shqipe, maqedone dhe gjuha turke në Medrese kanë statusin e gjuhës amtare, kurse gjuha arabe ka statusin e gjuhës profesionale, e gjuha angleze mësohet si gjuhë e huaj. Sa i përket lëndëve të cilat janë shoqërore, planprogrami zhvillohet në bazë të planprogramit për shkolla të mesme të miratuar nga Ministria e arsimit në RMV.⁹⁷ Lëndët të cilat mësohen në Medrese janë:

Lëndët fetare - profesionale

Nr	Lëndët	I	II	III	IV	Gjithsej
1	Kiraet	4	4	4	4	16
2	Akaid	2	2	2	2	8
3	Fikh	2	2	2	2	8
4	Ahlak	2	2			4
5	Da've - Retorikë			2		2
6	Histori Islame	2	2			4
7	Sire Nebevije			2		2
8	Civilizim dhe kultur Islame				2	2
9	Shkenca Kur'anore			2		2
0	1 Tefsir				2	2
1	1 Shkenca e hadithit			2		2

⁹⁶ Medreseja Q.R. Isa Beu, Arkivi Shtetëror R.M. në Shkup, K. 3. 1. 953. 3. 3. 554-555.

⁹⁷ <https://medreseja-isabeu.com/plan-programi/>

1	Hadith				2	2
2						
1	Usuli Fikh				2	2
3						
		12	12	16	16	5
					6	

Gjuhët

<i>r</i>	<i>N</i>	Lëndët	I	II	III	IV	V	Gjiths
				I			V	ej
1		Gjuhë shqipe	2	2	2	2	2	8
2		Gjuhë maqedone	2	2	2	2	2	8
3		Gjuhë turke	2	2	2	2	2	8
4		Gjuhë arabe	4	4	4	4	4	16
5		Gjuhë angleze	2	2	2	2	2	8
			12	1	1	1	1	48
				2	2	2	2	

Lëndët shoqërore - shkencore

<i>Nr</i>	Lëndët	I	II	III	IV	Gjithsej
1	Histori		2			4
2	Gjeografi					2
3	Informatikë					2
4	Matematikë		2			4
5	Biologji		2			4
6	Filozofi				2	2
7	Sociologji				2	2
8	Psikologji - Logjikë			2		2
9	Pedagogji - Didaktikë				2	2
10	Kimi		2	2		4
11	Fizikë		2	2		4
12	Edukatë fizike		1	1	1	4
		11	11	7	7	36

Në medresenë “Isa Beu” gjithsej janë 30 lëndë gjatë katër viteve shkollore. Gjatë javës mbahen 140 orë mësimore dhe ora e klasës.

3.4 Drejtori i medresesë “Isa Beu”

Drejtori i kryen të gjitha punët e parapara me Statusin e medresesë, e prezanton dhe përfaqëson medresenë, angazhohet për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor, etj. Drejtori i medresesë “Isa Beu” aktualisht është Ibrahim Idrizi. Ibrahim Idrizi ka lindur më datë

18.05.1963 në fshatin Sfillare e Poshtme, fshat ky në rrethinën e qytetit të Shkupit. Shkollimi fillor e kreu në vendlindje, ndërsa në vitin 1978/79 regjistron shkollën e mesme në medresenë “Alaudin” në qytetin e Prishtinës. Diplomon në vitin 1983 më sukses të shkëlqyer. Fati i jetës dhe dëshira e madhe për të mësuar Fenë Islame e dërgon atë në qytetin e Sarajevës, ku do t’i vazhdon studimet Universitare në fakultetin Teologjik ku dhe arrin të diplomoj në vitin 1988. Pas disa viteve jashtë vendit në kërkim të diturisë dhe mësimi të fjalës së Allahut vendos që diturinë e tij ta ndaj me bashkëqytetarët e vendit tonë. Në vitin 1989 do të punësohet si edukator në Medresenë “Isa Beu- Shkup”, ndërsa më vitin 1991 do të emërohet si punëdrejtues në Medrese, detyrë që do ta ushtron për po thuajse 10 vite deri në vitin 2001. Ajo që duhet përmendur është se nga viti 1991 deri në shkatërrimin e Jugosllavisë ka qenë Anëtarë i Kuvendit Suprem të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë. Nga viti 2001 deri në vitin 2006/07 do të punon si profesor i lëndëve Da’ve, Akaid, Retorikë, Psikologjisë dhe Pedagogjisë. Krahas kësaj dhe obligimeve të shumta ai nuk është ndalur se publikuar shkrime në shtypin fetar në Maqedoni si dhe jashtë kufijve të saj.

Në vitin 2007 rikthehet përsëri në postin punëdrejtues i Medresesë edhe atë për një vit deri në vitin 2008. Nga viti 2008/09 deri në vitin 2011 do të jetë ushtrues detyrë të Drejtorit (U.D Drejtor). Ndërsa viti 2011 do të jetë viti kur ai do të emërohet në postin e Drejtorit të Medresesë “Isa Beu”- Shkup, ku dhe aktualisht është bartës i këtij posti.⁹⁸ Me drejtorin e medresesë “Isa Beu” Ibrahim Idrizi pata nderin ta takojë dhe të bashkë bisedojmë rreth medresesë “Isa Beu”. Ai u shpreh se ishte i kënaqur me nxënësit dhe me profesorët e medresesë. Ajo që e preokuponte më së shumti ishte mos akreditimi i medresesë “Isa Beu” nga ana e Ministrisë së Arsimit. Gjithashtu ai tha se medreseja nuk ka buxhetin e vet, ajo është e nvarur nga Bashkësia Fetare Islame. Kjo e bën që medreseja të hasë vështirë në menaxhim, pasi shpesh herë mungojnë mjetet financiare për të realizuar një projekt të caktuar.

4. Kapitulli IV – Hulumtimi empirik mbi organizimin, menaxhimin dhe funksionimin e medresesë në RMV

⁹⁸ <https://medreseja-isabeu.com/administrata/drejtori/>

4.1 Metodologjia

Metodologjia e kërkimit përfshinë mbledhjen e të dhënave relevante nga metoda të ndryshme kërkimore dhe përpilimin e të dhënave në mënyrë që të analizohen të dhënat, që të arrihet ndërtimi i duhur i projektit hulumtues. Metodatat hulumtuese të cilat janë përdorur në këtë punim janë:

Metoda kualitative (cilësore) – kjo metodë në këtë hulumtim ka të bëjë me kategorizimin që nuk janë numerike, derivohet me fjalë, mund të kenë tipare fizike, të pa standardizuara që rëndom shprehen në kategori dhe duke përdorur teknikat e konceptualizimit. Kjo metodë përcaktonë sasinë e të dhënave dhe të përgjithësoj rezultatet nga një mostër të të dhënave. Përparësi e kësaj metode është veçanërisht efektive për të studiuar delikatesat dhe avantazhet e hulumtimit kualitativ që është fleksibilitet që kjo metodë lejon. Metoda cilësore siguronë kuptimin dhe sqarimin e rasteve studimore, objekteve të hulumtimit, nga prizmi historik e filozofik, duke grumbulluar të dhëna e informacione me qëllim të krahasimit të rasteve apo duke u bazuar në një rast të vetëm studimor.

Metoda statistikore – përfshinë mbledhjen, klasifikimin, organizimin, analizimin dhe interpretimin e informatave numerike me qëllim të marrjes së vendimeve efikase. Në këtë metodë kemi bërë mbledhjen e të dhënave nga ana e librave të botuara nga autorët ndërkombëtarë, literatura të cilat janë marrë nga web-faqet e besuara në internet. Këto hulumtime i kemi përpunuar dhe e kemi bërë prezantimin e të dhënave në shqyrtimin e literaturës. Në bazë të metodave të përdorura hulumtimi do të orientohet me theks të veçantë drejt risqeve të cilat do të ndikojnë në reputacionin e institucioneve financiare. Bazuar në hulumtimin e bërë kemi arritur në një fazë për të kuptuar kuadrin teorik duke përfshirë hipotezat e përgjithshme si dhe të dhënat e mbledhura nga shqyrtimi i literaturës.

4.2 Lënda e hulumtimit

Një shkollë që funksion mirë dhe menaxhimi i mirë janë thelbësore për krijimin dhe ruajtjen e besimit ndaj ministrisë së arsimit, dhe për krijimin e reformave të nevojshme strukturore për rritjen intelektit në shoqëri. Rëndësia e një menaxhimi të mirë është bërë

evidente veçanërisht në vendin tonë. Burimet financiare të kufizuara i fokusuan diskutimet e nivelit kombëtar në çështjen e arsimit, duke e bërë të qartë se menaxhimi i mirë dhe burimet financiare kanë ndikim të madh në mënyrën e organizimit arsimorë. Një shkollë e menaxhuar në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale, planifikimi dhe koordinimi më i mirë i politikave, procedurat e mira administrative dhe kurrikulat kanë rëndësi thelbësore për funksionimin e arsimit dhe për zbatimin e reformave që nevojiten për shkollat. Medreseja “Isa Beu” duhet të shtojë përpjekjen e saj për të përmirësuar nivelin arsimorë në të gjitha nivelet në bazë të strategjive kombëtare. Për të drejtuar procesin e reformave kërkohet një përkushtim i fuqishëm politik. Shkollat janë themeli i funksionimit të shtetit, përcakton aftësinë e shoqërisë për të ofruar shërbime publike dhe për të inkurajuar konkurrencën dhe zhvillimin e vendit. Medreseja “Isa Beu” synon të shfrytëzojë maksimalisht mekanizmat dhe forumet ekzistuese për të çuar përpara reformat, qoftë përmes strukturave të ministrisë së arsimit, qoftë nëpërmjet iniciativave të saja. Prandaj, lënda e hulumtimit ishte të analizohet organizimi, menaxhimi dhe funksionimi i medresesë “Isa Beu” në Maqedoninë e Veriut, dhe me anë të analizës të vlerësohet efikasiteti i kësaj shkolle.

4.3 Qëllimet e hulumtimit

Organizimi, menaxhimi dhe funksionimi i medresesë është një shtyllë e procesit të ngritjes së intelektit arsimorë. Të tri këto shtylla janë të lidhura ngushtë dhe përbëjnë çështje ndër-sektoriale me rëndësi thelbësore për suksesin e reformave arsimore. Një shkollë publike që funksionon mirë është e domosdoshme për një menaxhim demokratik. Gjithashtu, ajo ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e nxënësve për të ofruar maksimumin dhe për të rritur konkurrencën dhe zhvillimin. Organizimi, menaxhimi dhe funksionimi i medresesë duhet të çojë në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit dhe të sigurojë një fokus më të madh në nevojat e komunitetit musliman. Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë dhe ekzaminojë kornizat ekzistuese, të analizojë organizimin, menaxhimin dhe funksionimin e medresesë, dhe të propozojë rekomandime dhe konkluzione për përforcimin e kornizave ekzistuese, hapat e nevojshme për një arsim që do të ofrojë cilësi për qytetarët e komunitetit musliman të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pika fillestare e hulumtimit ishte përcaktimi i qëllimeve të hulumtimit. Ky proces filloi në fillim të vitit 2022 kur lindi interesi për të punuar në temën organizimi, menaxhimi dhe funksionimi i medresesë “Isa Beu”. Gjatë këtij viti u realizua një proces i mbledhjes së grumbullimit materialeve. Pas sigurimit të materialit të mjaftueshëm, u bë analiza e burimeve të ndryshme primare dhe sekondare, duke synuar identifikimin, krahasimin dhe sistemimin e pengesave dhe faktorëve të suksesit që po ndikojnë në organizimin, menaxhimin dhe funksionimin e medresesë “Isa Beu”. Për më tepër, kjo pjesë përfshiu në analizë të thellë të të dhënave të disponueshme nga burime të ndryshme (informacione përkatëse zyrtare, ligje, raporte, faqe të institucioneve relevante, burime nga internetit dhe dokumente të tjera përkatëse), me qëllim që të përcaktojë karakteristikat më të rëndësishme që lejojnë të shihet pamja reale e reformave.

4.4 Hipotezat e hulumtimit

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjatë viteve të fundit, nuk ka pasur ndonjë zhvillim të dukshëm dhe përparim në arsim në përgjithësi, po ashtu edhe medreseja “Isa Beu” edhe pse është një shkollë mirë e organizuar nuk dallohet shumë nga shkollat e tjera të mesme. Rrjedhimisht nga këtu janë definuar më poshtë hipotezat që do të shtjellohen në këtë hulumtim.

Organizimi, menaxhimi dhe funksionimi i medresesë “Isa Beu” funksionojnë në mënyrë efikase në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Hipotezat ndihmëse:

Medreseja “Isa Beu” duhet të rinovojë objektet infrastrukturore.

Medreseja “Isa Beu” është e penalizuar, për shkak të mos akreditimit të saj nga ana e ministrisë së arsimit.

Politizimi i arsimit është një ndër pengesat kryesore për organizimin, menaxhimin dhe funksionimin e medresesë “Isa Beu”

4.5 Metodat e përdorura për vlerësimet cilësore dhe sasior

4.5.1 Metoda e grumbullimit të të dhënave

Mbledhja e të dhënave është e detyrueshme në mënyrë që hulumtimi të jetë përfunduar. Të dhënat janë të ndara në dy lloje, ato primare dhe ato sekondare. Të dhënat sekondare janë të dhëna që tashmë janë mbledhur për qëllime të problemit në fjalë "(Malhotra dhe Birks 2003). Lidhur me të dhënat primare, "ata kanë origjinën nga një studiu për qëllimin specifik të adresimit të problemit që merren.⁹⁹ Këto të dhëna mbledhen nga studiuesit individualisht dhe procedura e mbledhjes së tyre është më e shtrenjtë dhe konsumojnë kohë në krahasim me ato sekondare (Sekaran, 2003). Një nga metodat më të mira për të mbledhur të dhënat primare është pyetësi, i cili është metoda e zgjedhur për këtë studim të veçantë. Ky është instrumenti më i mirë pasi është më i lirë dhe merr më pak kohë. Për më tepër, përdorimi i një pyetësi nuk mund të çojë në njëanshmëri intervistuesit (Malhotra dhe Birks, 2003). Përveç kësaj, ekziston mundësia për të të anketuarëve për t'iu përgjigjur pyetësorëve në lehtësi dhe diskrecion (Gill & Johnson, 1997).¹⁰⁰ Metodat e këtij hulumtimi konsistojnë në përgatitjen e modelit kërkimor cilësor dhe sasior që buron nga nevojat e hulumtimit. Në secilën fazë të projektit kërkimor, do të bëhet një analizë e detajuar e të dhënave të mbledhura. Si fillim do të realizohet një analizë e kontekstit thelbësor teorik, metodologjisë dhe kontekstit kërkimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, bazuar në rishikimin e të dhënave cilësore. Prandaj, kërkimi cilësor është planifikuar dhe realizuar me disa institucione relevante dhe politike bërësve që janë përfshirë në reformat në Administratën Publike. Kjo pjesë e hulumtimit ka një rol plotësues; më saktësisht, gjetjet e tij do të shërbejnë vetëm për nevojat e hulumtimit sasior (sondazhit). Kjo do të thotë që informacioni i mbledhur gjatë intervistave do të përdoret kryesisht për të përgatitur pyetësin.

Ky proces zgjati nga shkurti i vitit 2022 dhe zgjati deri në qershor të vitit 2022 ku dhe u përgatitën versionet e para të intervistës dhe sondazhit. Duke u bazuar në gjetjet e hulumtimit dhe analizës së dokumentacionit, një sërë pyetjesh për intervistën, pyetësin dhe metodologjinë përkatëse u hartuan për hulumtimin. Ndërsa hulumtimi sasior u realizua për të siguruar informacion të plotë në lidhje me organizimin, menaxhimin dhe funksionimin

⁹⁹ Malhotra dhe Birks 2003, f.85

¹⁰⁰ Gill & Johnson, 1997.

e medresesë. Pjesa e hulumtimit sasior realizohet përmes pyetësorit që ka për qëllim të mbledhë informacione në lidhje me një numër temash esenciale siç janë (të dhënat elementare rreth organizimit të medresesë, raportet nxënës-profesor, përshkrimi i vendit të mësimit, kurrikula e shkollave, përvoja profesionale, trajnimet e realizuara etj.). Pyetësi i hulumtimit të këtij studimi përfshin 34 pyetje. Pyetjet kanë të bëjnë me metodat dhe mënyrat se si nxënësit zhvillojnë procesin arsimorë dhe në reformat që janë të nevojshme për medresenë. Në këtë mënyrë, do të identifikohet nëse medreseja ndjek zhvillimet e reja teknologjike dhe cilat janë përfitimet që mund të rrjedhin nga përdorimi i tyre. Pyetësi është dërguar direkt te nxënësit e anketuar. Nxënësit janë përgjigjur në mënyrë anonime, shumë të lirë dhe mund të përgjigjen pyetjeve shumë lehtë. Të anketuarit mund t'u përgjigjen pyetjeve pa asnjë vështirësi dhe pa kushtuar shumë kohë. Për më tepër, kjo formë e pyetësorit mund të shndërrohet lehtësisht në dizajne numerik, i cili është i përshtatshëm për analiza statistikore që ka nevojë për këtë studim. Procesi i sondazhit u krye gjatë muajit prill dhe maj 2022. Bazuar në analizën e të dhënave cilësore dhe sasiore u përgatitën rezultatet si dhe u hartuan përfundimet gjatë periudhës korrik dhe gusht 2022. Gjatë hulumtimit janë përfshirë disa metoda të ndryshme si: analiza dhe sinteza, metoda historike, metoda krahasuese, metoda statistikore si dhe metoda e anketimit të cilat janë përdorur në këtë proces.

4.5.2 Intervistat me institucione përkatëse

Siç është përmendur në pjesën e metodologjisë, para se të kryhej procesi i studimit, janë realizuar disa intervista me institucionet përkatëse të përfshira në organizimin e medresesë, duke përdorur pyetje të hapura. Kjo pjesë e studimit ishte e rëndësishme për të marrë perceptimin institucional mbi përmbajtjen organizimit si dhe për të marrë sugjerime të mundshme në lidhje me temat që duhet të përfshihen në pyetësin e sondazhit. Nga intervistat e realizuara është parë që në vitet e fundit medreseja ka pasur reforma të vazhdueshme, mirëpo duke e pasur parasysh që ky është një proces i gjerë dhe kompleks që kërkon një përkushtim të vazhdueshëm, përfshirë kapacitetet financiare, njerëzore dhe teknike që së bashku me kornizën ligjore të arrihet synimi i duhur, në raste të shumta procesi ngec dhe përballët me disa vështirësi. Intervistë zhvilluam me dekanin e Fakultetit shkencave islame në Shkup, Prof. Dr. Shaban Sulejmanin, ish profesor në medresenë “Isa Beu”. Profesori dha versionin e mendimit të tij për medresenë, tha se medreseja “Isa Beu”

është vatra e dijes islame në Maqedoninë e Veriut dhe se medresantët kanë dhënë një kontribut të jashtzakonshëm në çdo sferë të jetës.


Poashtu intervistë kemi zhvilluar edhe me drejtorin e medresesë “Isa Beu” Ibrahim Idrizi, i cili tha se medreseja ka hasur vështirësi të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës që ekziston, si problem kryesorë shprehi mos akreditimin e medresesë nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Disa nga çështjet që rezultuan se duhet të përfshihen dhe analizohen gjatë anketimit ishin: • përfaqësimi gjinor dhe ai etnik në administratë, • përfaqësimi i kategorive profesionale në administratë, • përfaqësimi i nëpunësve sipas përvojës profesionale, 73 • efikasiteti i administratës publike dhe nevojës për t’u reformuar, • realizimi i reformave në administratën publike • ndjekja e trajnimeve/aftësimeve profesionale në lidhje me reformat në administratë • informimi dhe kyçja në reformat e që kanë të bëjnë me “Hartimin e politikave dhe koordinim”, “menaxhimin e shërbimit publik dhe burimeve njerëzore” “Llogaridhënia dhe transparenca” si dhe “Ofrimin e shërbimeve dhe mbështetja për administratën”. • faktorizimi i nëpunësve shtetërorë në vendimmarrje.

4.6 Rezultatet nga hulumtimi empirik


Profili i përdoruesit/ të dhënat demografike Pas procesit të intervistimit dhe siç u përmend më herët në metodologji, u zhvillua pyetësi dhe u përcaktua grupi i synuar – nxënësit e medresesë “Isa Beu”. Përpilimi i pyetësorëve, në mënyrë anonime, është realizuar në javën e tretë të muajit maj 2022. Pyetësit iu përgjigjen 402 nxënës, prej tyre 136 meshkuj dhe 266 femra, prej vitit të I deri vitin e IV. Një përzgjedhje e tillë synonte të ofronte informacion më të saktë dhe gjithëpërfshirës për këtë temë. Sipas të dhënave të marra nga sondazhi rezultatet janë siç vijojnë.

Fig. 1 – Përqindja e të anketuarve.




Në pyetjen e parë të pyetësorit, si meshkujt ashtu edhe femrat, shumica janë përgjigjur se e kanë zgjedhur medresenë sepse është një shkollë mikpritëse, e organizuar mirë dhe njihet si një shkollë që funksionon mirë. Nga ky rezultat kuptojmë se shumica absolute e nxënësve të anketuar kanë mendim pozitiv për medresenë. Kohëve të fundit shpesh herë vërejmë në debate televizive apo nëpër rrjete sociale të thuhet se femrës te komuniteti musliman nuk i mundësohet që ajo të vazhdojë shkollimin, ose nëse i mundësohet, i imponohet drejtimi shkollorë. Nga ky anketim vërejmë se është e kundërta, vetëm 1% e të anketuarave u përgjigj se është detyruar nga familjarët që ta ndjekë këtë shkollë.

Fig. 2. E kam zgjedhur medresenë sepse(maksimum dy përgjigje):




Sa i përket çështjes së funksionimit të medresesë, shumica absolute si te gjinia mashkullore, si te ajo femërorë janë përgjigjur se medreseja është një shkollë që funksionon mirë. Vetëm një përqindje shumë e vogël, e cila nuk e kalon as 5%, janë përgjigjur se nuk pajtohen apo aspak nuk pajtohen se është një shkollë që funksionon mirë. Sigurisht edhe medreseja ka defektet e veta si çdo shkollë tjetër, por nga ky sondazh shohim se në përgjithësi funksionimi i medresesë është në rregull.

Fig. 3. Medreseja është një shkollë që funksionon mirë:




Në pyetjen se udhëheqësit e shkollës dhe profesorët a janë në dispozicion të dëgjojnë problemet e nxënësve dhe të gjejnë zgjidhje, janë përgjigjur mbi 90% e të anketuarve me përgjigje pozitive plotësisht pajtohen apo pajtohen, se udhëheqësit e shkollës apo profesorët janë pranë nxënësve për zgjidhjen e problemeve të mundshme. Sigurisht që një përgjigje e tillë pritej pasi medreseja është një shkollë fetare, ku nuk duhet të mungojë përkrahja e nxënësve në çdo aspekt.

Fig. 4. Udhëheqësit e shkollës dhe profesorët a janë në dispozicion të dëgjojnë problemet e nxënësve dhe të gjejnë zgjidhje:




Mund të themi në përgjithësi se sekretari i shkollës ka për detyrë të menaxhojë disa aspekte përkatëse burokratike dhe administrative, konkretisht bëhet fjalë për gjithçka që ka të bëjë me praktikën, dokumentet dhe certifikatat në shkollë, për këtë arsye kontributi i sekretarit është përgjithësisht thelbësor për funksionimin e institucionit për të cilin punon, qoftë institucion arsimor, qoftë shoqëri publike apo private e një lloji tjetër. Shohim se nxënësit janë të kënaqur me shërbimin e sekretarit të medresesë, pakënaqësitë janë minimale të cilat nuk e kalojnë as 10%.

Fig. 5. Sekretari i shkollës ofron shërbime të mjaftueshme:



Për të funksionuar një shkollë mirë sigurisht që nuk duhet të mungojë bashkëpunimi mes nxënësve dhe profesorëve. Në pyetjen se a bashkëpunojnë profesorët për të garantuar një funksionim të mirë të shkollës, shohim se shumica absolute e nxënësve të anketuar janë përgjigjur se plotësisht pajtohen apo pajtohen me angazhimin e profesorëve në drejtim të bashkëpunimit të tyre. Kjo sigurisht ndikon pozitivisht për një funksionim të mirë të një institucioni siç është shkolla.


Fig. 6. Profesorët bashkëpunojnë për të garantuar një funksionim të mirë të shkollës:



Librat nuk mund të zëvendësohen edhe në epokën dixhitale. Nuk mund të zëvendësohet me raftet e librave bota dixitale, pasi libri zë një vend të veçantë në zemrën e lexuesit dhe nxënësve. Medreseja është kujdesur gjithmonë për nxënësit për të pasur literaturë të mjaftueshme. Edhe pse shumë herë ka hasur në vështirësi, pasi kanë munguar mjetet financiare dhe nuk ka pasur asnjë ndihmë nga shteti, konkretisht nga ministria e arsimit, gjithmonë udhëheqësit e medresesë kanë gjetur zgjidhje që nxënësve mos iu


mungojnë librat për të ndjekur procesin arsimorë. Edhe nga përgjigja e të anketuarve vërehet se literatura nuk ka munguar për nevojat e nxënësve.

Fig. 7. Medreseja ofron literaturë mjaftueshëm për nevojat e nxënësve:




Klasat janë vendi ku zhvillohen aktivitetet mësimore, shumicën e kohës nxënësit e kalojnë nëpër klasa duke mësuar, sigurisht se një ambient i mirë infrastrukturor luan rol në psikologjinë e nxënësit për të qenë më i koncentruar gjatë procesit mësimorë. Në medresenë “Isa Beu” infrastruktura e klasave ndryshon, në disa paralele gjendja e klasave është më e mirë si për shembull në paralelen e femrave në Gostivar, ku nuk mungojnë as kabinetet si i informatikës, biologjisë, kimisë dhe artit figurativ. Kurse gjendja më e vështirë është në Shkup, veçanërisht në paralelen e femrave ku klasat janë të ngushta dhe kanë nevojë që të rinovohen. Edhe pse shumica janë përgjigjur se pajtohen se klasat janë të rregulluara mirë dhe plotësojnë kushtet për mësim, shohim se përafërsisht 1/3 e të anketuarve tregojnë pakënaqësi në lidhje me infrastrukturën e klasave. Nga ajo që vërehet gjatë zhvillimit të anketimit me nxënësit, vërehet se disa paralele kanë nevojë për rinovimin e klasave, kurse disa të tjera plotësonin të gjitha kushtet e një klase se si duhet të jetë ajo.

Fig. 8. Klasat janë të rregulluara mirë dhe i plotësojnë kushtet për mësim:



Medresesë “Isa Beu” nuk i mungojnë hapësirat për të përmbushur nevojat e nxënësve, pasi Bashkësia Fetare Islame posedon vakëfe të shumta. Paralelja qendrore e meshkujve në Shkup posedon një hapësirë të gjërë infrastrukturore, ku gjendet edhe konvikti i nxënësve dhe fusha sportive, sigurisht edhe hapësirat e gjelbëruara nuk mungojnë. Hapësirat në dispozicion për nevojat e nxënësve pak më të reduktuara janë në paralelen e femrave në Tetovë, por sigurisht plotësojnë nevojat e nxënësve. Nga përgjigja e të anketuarve vërejmë se shumica e tyre plotësisht pajtohen apo pajtohen se hapësirat në dispozicion iu përgjigjen nevojave të nxënësve.


Fig. 9. Hapësirat në dispozicion ju përgjigjen nevojave të nxënësve:



Plani i emergjencës dhe evakuimit është dokumenti që përmban të gjitha udhëzimet që duhet ndjekur në rast emergjence. Ky lloj dokumenti duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë. Medreseja “Isa Beu” posedon një plan të tillë. Shohim nga rezultatet se shumica e të


anketuarve janë përgjigjur se, plotësisht pajtohen apo pajtohen se ka kujdes për sigurinë e brendshme të shkollës.

Fig. 10. Ka kujdes për sigurinë e brendshme të shkollës (dalja e emergjencës, plani i emergjencës):




Në pyetjen paraprake, vërejtëm se shumica e të anketuarve u përgjigjen se ka kujdes nga ana e shkollës për sigurinë e brendshme, mirëpo në këtë pyetje shohim se 1/3 e të anketuarve përgjigjen se nuk janë të informuar për planin e emergjencës. Kjo tregon se rregulloret e përpiluara shpesh ndodhë që të mbesin vetëm në letër dhe mos të aplikohen në praktikë.

Fig. 11. Profesorët dhe nxënësit janë të informuar për planin e emergjencës:



Simboli i daljes emergjente është një shenjë që tregon praninë e një dalje emergjence. Simbol i miratuar ndërkombëtarisht në vitin 1985, u krijua nga stilisti japonez Yukio Ota në vitet 1970.¹⁰¹ Edhe në këtë pyetje vërejmë se 1/3 përsëri japin përgjigje negative, pra nuk pajtohen se senjalitika e daljes së emergjencës duket qartë.

Fig. 12. Shenjat e daljes së emergjencës duken qartë:




Si çdo shkollë tjetër fetare që pretendon të shpërndajë ideologjitë e saja në mesin shoqërisë, ashtu edhe medreseja “Isa Beu” sigurisht që pretendon të shpërndajë mesazhin hyjnorë në mesin e shoqërisë. Madje është edhe urdhër hyjnorë në fenë islame, në Kuranin Famëlartë thuhet: *“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!”*.¹⁰² Sigurisht se shumica absolute e të anketuarve janë përgjigjur se plotësisht pajtohen ose pajtohen se medreseja angazhohet të shpërndajë ideologjinë e saj fetare jashtë shkollës.

¹⁰¹ Julia Turner, The Big Red Word vs. the Little Green Man, Slate, 8 March 2010.


¹⁰² Sherif Ahmeti: Kurani përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Kaptina Nahl: 125.

Fig. 13. Medreseja angazhohet të shpërndajë ideologjitë e saja jashtë shkollës:



Tani më jemi në botën kompjuterike, botën e dixhitalizimit, shumë lehtë informatat mund të shpërndahen në gjithë botën për një kohë shumë të shkurtë, mjafton vetëm një klik. Edhe medreseja posedon webfaqen e saj ku publikon konkurset, njoftimet dhe çdo lloj aktiviteti të saj. Shumica, mbi 80% plotësisht pajtohen ose pajtohen se webfaqja e medresesë u ndihmon në lidhje me njoftime të ndryshme.


Fig. 14. Faqja e internetit të medresesë na ndihmon për informim:



Pesë objektet e medresesë "Isa Beu" ku zhvillohen orët mësimore, sigurisht që kanë nevojë të bëhen disa investime, me theks të veçantë objekti i paraleles së femrave në Shkup. Por, ka edhe objekte si objekti i paraleles së femrave në Gostivar, që nuk ka nevojë


për asnjë lloj rinovimi. Nga përgjigja e të anketuarve vërejmë se mbi 70% e tyre, plotësisht pajtohen ose pajtohen se objektet e medresesë kanë nevojë për renovim.

Fig. 15. Objektet e medresesë duhet të rinovohen:



Profesorët e kanë për detyrë të promovojnë vlera shoqërore te nxënësit, nëpërmjet njohurive dhe kontakteve me profesorët, individi krijon një marrëdhënie besimi me ta. Profesori mund të bëhet një figurë referimi për nxënësit, jo vetëm në transmetimin e njohurive disiplinore, por edhe në zhvillimin e mirëqenies psikologjike të nxënësve të tyre. Rezultatet e nxjerra nga anketimi na konfirmojnë se raportet mes profesorëve dhe nxënësve në medrese janë ekselente. Afër 95% e të anketuarve janë përgjigjur, plotësisht pajtohen ose pajtohen se profesorët janë të gatshëm të dialogojnë me nxënësit.


Fig. 16. Profesorët janë të gatshëm të dialogojnë me nxënësit:



Në një shkollë ku raportet mes profesorëve dhe nxënësve janë të shkëlqyera, sigurisht që nuk mund të mungojë edhe mënyra eksplicite e të informuarit për aktivitet


brenda shkollës. Mbi 85% e të anketuarve janë të kënaqur me shërbimet e medresesë në lidhje me mënyrën e komunikimit të njoftimeve të ndryshme.

Fig. 17. Informacionet e rëndësishme për aktivitetet e medresesë më komunikohen në mënyrë të qartë:



Gjatë viteve shkollore, nxënësit kanë nevojë për informata të ndryshme. Nëse një shkollë është e organizuar mirë, atëherë nxënësit e kanë shumë lehtë, sepse dinë kujt ti drejtohen për problemin që kanë. Nga rezultatet vërejmë se medreseja tregon seriozitet në këtë drejtim, pasi mbi 85% e të anketuarve kanë dhënë përgjigje pozitive, pra dinë kujt t'i drejtohen për ndonjë informacion që iu nevojitet.


Fig. 18. Kur kam nevojë për ndonjë informacion e di kujt t'i drejtohem:



Për sa u përket njoftimeve për aktivitetet e ndryshme didaktike të medresesë, shohim se shumica e të anketuarve kanë dhënë përgjigje pozitive. Mirëpo te gjinia


mashkullore shihet se mbi 20% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk pajtohen ose aspak nuk pajtohen se njoftohen për aktivitet didaktike.

Fig. 19. Informohem për aktivitetet e ndryshme didaktike të medresesë:



Njeriut i pëlqen ta ndjejë veten të rëndësishëm, veçanërisht kur është në vitet e adoleshencës së tij. Të marrësh në konsideratë mendimet e nxënësve për disa vendime është shumë e rëndësishme, për arsye se nxënësit e ndjenë veten faktorë, të rëndësishëm edhe ata. Në këtë pyetje shohim se afër 30% e nxënësve janë përgjigjur me përgjigje negative, pra nuk ndjehen të përfshirë në vendimet që merr medreseja.


Fig. 20. Në vendimet që merren nga medreseja këndvështrimi i nxënësve merret në konsideratë:



Në medresenë “Isa Beu” çdo pararele e saj posedon hapsirat e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e nxënësve, sigurisht që hapsirat që janë në dispozicion nuk janë me


standarte të larta, por janë komode për nxënësit e medresesë. Nga rezultatet e pyetësorit duken qartë pakënaqësitë e të anketuarëve por shumica e tyre, 65%, janë përgjigjur se ka hapësira për të mësuar edhe individualisht pas orarit të mësimit.

Fig. 21. Medreseja ofron hapësira individuale për nxënësit që duan të mësojnë pas orarit mësimorë:




Shkolla viteve të fundit ka ndryshuar në disa këndvështrime, simbol i këtij ndryshimi është regjistri elektronik. Regjistri elektronik është një aplikacion që mundëson prindërve të shohin dhe të analizojnë të gjitha të dhënat në lidhje me performancën akademike të fëmijëve të tyre. Këtu mund të shohin notat, mungesat, detyrat e shtëpisë dhe përmbajtjet mësimore. Regjistri elektronik është një sfidë e re si për profesorët poashtu edhe për prindërit. Nga këndvështrimi i nxënësve shohim se janë të ndarë në këtë pikë, pak më shumë se gjysma e të e anketuarëve mendojnë se regjistri elektronik ndihmon në aktivitetet shkollore.

Fig. 22. Përdorimi i regjistrit elektronik për të komunikuar disiplinën, vlerësimin, materialet didaktike, mungesat, vonesat, ndihmon:




Ekzistojnë strategji dhe metoda të ndryshme edukative. Nuk mund të thuhet se një metodë është më e mirë se tjetra: ato mund të përdoren herë pas herë në momente të ndryshme. Çdo profesor ka metodologjinë e tij edukative, këtë e vërteton edhe rezultati, pasi shumica absolute e të anketuarve janë përgjigjur se plotësisht pajtohen ose pajtohen se profesorët përdorin metodologji dhe strategji të ndryshme nga njëri tjetri.

Fig. 23. Çdo profesor përdorë metodologji didaktike dhe strategji edukative të ndryshme:




Një profesor ideal, përveç përgatitjeve akademike ai duhet të gjejë edhe metodologjinë e duhur për ta shprehur diturinë e tij në mënyrën më të lehtë, për ta kuptuar nxënësi. Strategjitë dhe metodologjitë e përdorura nga profesorët, nga rezultatet e dhëna duket të jenë valide dhe efikase. Afër 90% e nxënësve janë të kënaqur me metodologjitë e përdora nga profesorët e tyre.

Fig. 24. Strategjitë dhe metodologjitë e përdorura nga profesorët janë valide dhe efikase:




Plan programi mësimorë është organizimi i një sërë veprimesh që parashihen për profesorët që ti kryejnë në një kohë të caktuar, brenda shkollës ku operojnë. Planprogrami përpilohet drejtpërdrejt nga profesorët, individualisht ose në grup, ose nga Ministria e Arsimit. Nga rezultatet shohim se pothuajse $\frac{3}{4}$ e të anketuarëve janë të kënaqur me planprogramin mësimorë të medresesë.

Fig. 25. Planprogrami mësimorë është i qartë dhe i rregulluar si duhet:




Detyrat e shtëpisë nuk janë problem vetëm për ata që duhet t'i bëjnë: profesorët, prindërit, nxënësit për pothuajse të gjithë bien dakord në të shumtën e rasteve, se nuk ka nevojë që nxënësit të mbingarkohen me detyra të shtëpisë. Nga përgjigja e të anketuarëve shohim se detyrat e shtëpisë jepen në mënyrë të ekuilibruar në medresenë "Isa Beu".

Fig. 26. Detyrat e shtëpisë jepen në mënyrë të ekuilibruar:



Testimet e nxënësve tregojnë njohuritë që nxënësit kanë arritur në lëndë të caktuara. Është shumë e rëndësishme që nxënësi të jetë i njoftuar se në cilën periudhë të vitit shkollor do të mbahen testimet e lëndëve. Rreth 90% e të anketuarëve janë përgjigjur se plotësisht pajtohen ose pajtohen se testimet e lëndëve të ndryshme planifikohen me kohë paraprake të mjaftueshme për përgatitjen e nxënësve.


Fig. 27. Testimet e lëndëve të ndryshme planifikohen me kohë paraprake të mjaftueshme për përgatitjen e nxënësve:



Disa profesor nuk e komunikojnë notën e testit me gojë apo me shkrim para gjithë klasës, duke menduar se privatësia duhet të garantohet pavarësisht transparencës. Përveç regjistrimit të notës në regjistrin elektronik në kohë reale, mësuesi duhet t'ia komunikojë


atë nxënësit qartë dhe para gjithë klasës. Nga rezultati që shohim më poshtë kuptojmë se nxënësit e medresesë janë të kënaqur me mënyrën e komunikimit të vlerësimit të tyre.

Fig. 28. Çdo profesor komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente mënyrën e vlerësimit të testimit:



Pa dyshim, se një nga mënyrat më efikase për të rikuperuar është motivimi, është një konstrukt nga i cili varet efektiviteti i procesit të mësimdhënies. Ndoshta është mënyra më e rëndësishme. Shumica e nxënësve janë të kënaqur me ndihmën e profesorëve, vërehet edhe një pakënaqësi e cila nuk i kalon as 20% e të anketuarëve.


Fig. 29. Profesorët iu ofrojnë nxënësve që gjejnë vështirësi mënyrë efikase për të rikuperuar:



Mirënjohjet janë një stimulim për nxënësit, për ti motivuar që të ndjehen të dalluar, apo më të mirët e shkollës në këndvështrimin e të mësuarit. Në pyetjen, nxënësit më të mirë marrin mirënjohje, edhe pse shumica janë dakord, pothuajse 1/4 e të anketuarëve janë


përgjigjur se nuk pajtohen ose aspak nuk pajtohen se nxënësit më të mirë marrin mirënjohje.

Fig. 30. Nxënësit më të mirë marrin mirënjohje:




Medreseja “Isa Beu” është e vërtetë se ofron një nivel të lartë të përgatitjes. Nëse shohim kurikulën e medresesë do të shohim se nxënësit gjatë katër viteve shkollore përveç gjuhës shqipe ballafaqohen edhe me katër gjuhë të huaja (arabisht, maqedonisht, anglisht, turqisht). Përveç lëndëve fetare në medrese nxënësit mësojnë edhe lëndë të shkencave natyrore dhe shoqërore. Shumica e nxënësve të anketuar, mbi 80% plotësisht pajtohen ose pajtohen se medreseja ofron një nivel të lartë të përgatitjes.

Fig. 31. Medreseja ofron një nivel të lartë të përgatitjes:




Është shumë e rëndësishme që raportet mes nxënësve dhe shkollës ku mësojnë, të jenë miqësore dhe tolerante brenda kornizave të lejuara. Nxënësi duhet ta kuptojë institucionin arsimorë nëse nuk mund ti ofrojë ndonjë shërbim eventual për shkaqe financiare apo për ndonjë arsye tjetër racionale. Gjithashtu edhe institucioni arsimorë duhet të ketë një qasje sa më të lehtë me nxënësit, për ta kuptuar gjendjen e nxënësit në parametra të ndryshme. Nga rezultatet shohim se nxënësit janë shumë të kënaqur, kjo tregon se raportet mes nxënësve dhe medresesë janë miqësore dhe tolerante.

Fig. 32. Raportet mes nxënësve dhe medresesë janë miqësore dhe tolerante:




Respektimi i rregullave luan një rol të rëndësishëm në ambientin intern të shkollë, shumica e problemeve që hasen në menaxhimin e shkollës varen nga mosrespektimi i rregullave. Brenda shkollës janë disa rregulla për një marrëdhënie të mirë mes profesorëve dhe nxënësve, për funksionimin e grupit të klasës dhe për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm mësimor. Shumica e nxënësve të anketuar plotësisht pajtohen ose pajtohen se nxënësit e medresesë respektojnë rregullat interne. Kjo me theks të veçantë vërehet te gjinia femërorë, mbi 95%. Kurse te gjinia mashkullore shohim se mbi 20% e të anketuarëve nuk pajtohen ose aspak nuk pajtohen.

Fig. 33. Nxënësit e medresesë respektojnë rregullat interne:



Profesorët përveç se duhet të kenë relacion pozitiv mes tyre dhe nxënësve, ata duhet të promovojnë relacione pozitive edhe në mesin nxënësve. Në medresenë “Isa Beu” nga rezultatet vërejmë se mbi 85% e të anketuarëve janë të kënaqur me promovimin e relacioneve pozitive mes nxënësve nga ana e profesorëve.


Fig. 34. Profesorët promovojnë relacione pozitive (dëgjim, dialog, inkurajim) në mes të nxënësve:



Nxënësit gjatë viteve shkollore mund të hasin në probleme të fushave të ndryshme, profesori duhet ta luaj rolin e mentorit të jetës për nxënësin. Çdo problematikë që shfaqin nxënësit apo vërejnë profesorët duhet të merret në konsideratë me seriozitetin më të madh, pasi sa më herët të konfrontohemi me problemet aq më lehtë mund të zgjidhen. Në përgjithësi nxënësit e anketuar janë të kënaqur me interesimin e profesorëve për

problematikat e tyre. Shihet një pakënaqësi më e madhe te gjinia mashkullore respektivisht nga ajo femërore.

Fig. 35. Profesorët i marrin në konsideratë problematikat e nxënësve:



KONKLuzionet

Studimi doli në përfundimin se Medreseja “Isa Beu” mbetet një institucion edukativo-arsimor ku mësimdhënësit bartin diturinë dhe edukatën islame te nxënësit, ndërsa nxënësit e bartin këtë dituri dhe moral te popullata përmes të shërbyerit si imamë, mualimë, hatibë ose përmes kontakteve që kanë me njerëzit. Poashtu menaxhmenti dhe profesorët e Medresesë kanë një raport të shkëlqyer me nxënësit e Medresesë. Medreseja nuk ka burime financiare të mjaftueshme. Ministria e arsimit nuk akrediton medresenë dhe si shkak i kësaj nuk ka monitorimin e duhur të Medresesë. Për mjedisin mësimor, mund të konstatohet se profesorët e Medresesë janë model për nxënësit për të mësuar. Nxënësit e Medresesë i ndjekin profesorët e tyre brenda dhe jashtë Medresesë si udhëheqës shpirtërorë. Objektivi kryesor i Medresesë është përhapja e fesë, kështu që mjedisi i Medresesë i formon nxënësit në njerëz të tillë fetarë që ndjekin profesorët e tyre. Medreseja synon të jetë sinonim për një shkollë elitare, ku profesorët kryejnë në mënyrë të organizuar mësim-besimin e fesë islame. Me hapjen e paraleleve të femrave dhe me përmirësimin e cilësisë përgatitore në përgjithësi, Medreseja tenton të rangohet në një shkollë e cila është privilegj mbi të gjitha shkollat e mesme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Poashtu Medreseja mundohet të nxjerrë kuadro të përgatitura në

treg për ngritjen e islamin institucional. Medreseja është një vatër edukativo-arsimore e sigurt në të gjitha kuptimet. Mirëpo, që të përmbushen objektivat për çka ajo është themeluar, mendoj se duhet të bëhet një riorganizim i këtyre enteve edukativo-arsimore sa më shpejt.

REKOMANDIME

- Ministria e arsimit duhet ta akreditojë medresenë dhe ta konsiderojë si institucionet e tjera arsimore publike.
- Bashkësia Fetare Islame duhet t'i ofrojë Medresesë mjete moderne mësimore.
- Medreseja duhet të ofrojë trajnime për profesorët në mënyrë që të përmirësojnë aftësitë e tyre të mësimdhënies dhe metodologjitë e mësimdhënies.
- Bashkësia Fetare Islame në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit duhet të sigurojë financim dhe lehtësime të tjera për medresenë.
- Bashkësia Fetare Islame në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit duhet të detyrojnë medresenë për emërimin e vetëm atyre profesorëve që kanë arsim profesional për mësimdhënie.
- Ministria e arsimit duhet të caktojë monitorues që duhet të vizitojnë Medresenë herë pas here, ashtu siç vizitojnë institucionin arsimor publik për të monitoruar Medresenë në referencën e të drejtave të nxënësve dhe çështje të tjera.
- Bashkësia Fetare Islame duhet ti jap liri të plotë medresesë në menaxhimin e saj.

Bibliografia

- Islamic Religious Schools, Madrasas: Background Christopher M. Blanchard Analyst in Middle Eastern Affairs Foreign Affairs, Defense, and Trade Division. Order Code RS21654 Updated January 23, 2008
- Inside Madrassas Understanding and engaging with British-Muslim faith supplementary schools, Myriam Cherti and Laura Bradley November 2011 © IPPR 2011 report Institute for Public Policy Research
- Halil Inalcik: "Learning, the Medrese, and the Ulema." In The Ottoman Empire: The Classical Age 1300–1600. New York: Praeger, 1973
- Muhammed Hamidullah: İslam Peygamberi, Yeni Safak, İstanbul, 1980
- Mehmet Dag & Hivzirrahman R. Öymen: İslam Egitim Tarihi, Ankara, 1976
- Ahmed Emin: Fecru'l-İslam, çev.: A. Serdaroğlu, Ankara, 1976
- Ahmed Çelebi & Ali Yardım: İslamda Eğitim öğretim Tarihi, Damla Yay, 1998
- Hitti, P.K. & Salih Tuğ: İslam Tarihi, Boğaziçi Yayınları, İstanbul, 1980
- Cahid Baltacı: XV-XVI. Asırlarda Osmanlı Medreseleri, İrfan Matbaası, İstanbul, 1976
- Boyle, Helen, Quranic School Strategy and Mini Needs Assessment, Trip Report to Nigeria, 2002
- Ahmed, Munir, Islamic Education Prior to the Establishment of Madrassa, Journal of Islamic Studies, 1987
- Islamic Education A Brief History of Madrassas With Comments on Curricula and Current Pedagogical Practices By Uzma Anzar, Ph.D. March 2003
- Mustafa Sibai: İslam Medeniyetinden Altın Tablolar, Second Edition, Trans. N. Demircan-M.p. Şimşek, Uysal Kitabevi, Konya, 1979
- Ahmed, Munir, Islamic Education Prior to the Establishment of Madrassa, Journal of Islamic Studies, 1987
- Haqqani, Husain, Islam's Medieval Outposts, Foreign Policy Magazine, November 2002
- Doreen Ingrams: The Awakened: Women in Iraq, London, 1983

- Anthony Nutting: The Arabs. HOLLYS and CARTER, Cambridge, United Kingdom 1964
- James E. Lindsay: Daily Life in the Medieval Islamic World, Greenwood Publishing Group, 2005
- Guity Nashat & Lois Beck: Women in Iran from the Rise of Islam to 1800, University of Illinois Press, 2003
- A Secret History, By Carla Power Feb. 25, 2007 www.nytimes.com
- Daniel Goffman: The Ottoman Empire and Early Modern Europe. United Kingdom: U of Cambridge, 2002
- Islamic Religious Schools, Madrasas: Background Christopher M. Blanchard, Analyst in Middle Eastern Affairs
- Foreign Affairs, Defense, and Trade Division Order Code RS21654 Updated January 23, 2008
- Sonja Brentjes: Teaching and Learning the Sciences in Islamicate Societies (800-1700). Turnhout, Belgium: BREPOLs, 2018
- Daniel Goffman: The Ottoman Empire and Early Modern Europe. United Kingdom: U of Cambridge P, 2002
- Myriam Renaud, Ph.D. Candidate in Religious Thought and Ethics, University of Chicago, 2017
- Zahra Rahimi: "Govt Plans to Bring Madrassas Under State Control". TOLONews (8 January 2021)
- Siddiqi, ABM Saiful Islam "Madrasah". In Islam, Sirajul; Jamal, Ahmed A. (eds.). Banglapedia: National Encyclopedia of Bangladesh (Second ed.). Asiatic Society of Bangladesh. 2012
- "Qawmi madrasas under watch". The Daily Star. 2009-03-31.
- Tahmima Anam: "An education: Inside Bangladesh's madrasas". The Guardian. (20 May 2011).
- Padmaja Nair: The State and Madrasas in India. Working Paper. University of Birmingham, Birmingham, UK, (2009)
- Christine Fair: "The Enduring Madrasa Myth". 2012, Current History.

- Kamila Hyat: "No room for doubt and division". The News International. Archived from the original on 4 September 2009. Retrieved 25 September 2008.
- Arjun Rajbanshi: "A madrasa blends traditional education with modern to keep up with the changing times". The Kathmandu Post. (27/10/2019).
- Asadullah M Niaz "Poor Indonesian families are more likely to send their daughters to cheap Islamic schools". The Conversation. (6 March 2020).
- "Background of Madrasahs". muis.gov.sg. 1994. Archived from the original on 2015-04-02. Retrieved 2015-03-18.
- Mogato Manny: "Catholic Philippines teaches Islam in state schools". Reuters. (21 March 2007).
- "BARMM to grant special eligibility for Madaris teachers in new education code". BARMM Official Website. Bangsamoro Information Office. 2021-05-19. Retrieved 19 May 2021.
- Pedersen, J.; Makdisi, G.; Rahman, Munibur; Hillenbrand, R. "Madrasa". *Encyclopaedia of Islam, Second Edition*. Brill. (2012).
- Kubisch Natascha: "Maghreb - Architecture" in Hattstein, Markus and Delius, Peter (eds.) *Islam: Art and Architecture*. (2011)
- Binous Jamila; Baklouti Naceur; Ben Tanfous Aziza; Bouteraa Kadri; Rammah Mourad; Zouari Ali (2002). *Ifriqiya: Thirteen Centuries of Art and Architecture in Tunisia* (2nd ed.). Museum With No Frontiers, MWNF.
- Lintz Yannick; Déléry Claire; Tuil Leonetti Bulle: *Maroc médiéval: Un empire de l'Afrique à l'Espagne*. Paris: Louvre éditions. (2014).
- Parker Richard: *A practical guide to Islamic Monuments in Morocco*. Charlottesville, VA: The Baraka Press. (1981)
- Robert Irwin: *Ibn Khaldun: An Intellectual Biography*. Princeton University Press. 2019
- Parker, Richard (1981). *A practical guide to Islamic Monuments in Morocco*. Charlottesville, VA: The Baraka Press. (1981)

- Binous Jamila; Baklouti Naceur; Ben Tanfous Aziza; Bouteraa, Kadri; Rammah, Mourad; Zouari, Ali: Ifriqiya: Thirteen Centuries of Art and Architecture in Tunisia. Islamic Art in the Mediterranean. Museum With No Frontiers & Ministry of Culture, the National Institute of Heritage, Tunis. (2010).
- Musli Bajrami, Periudha historike e Medresesë së Isa Beut, Gostivar, 2005
- Dr. S. Rizaj, Historia e përgjithshme, Prishtinë, 1985
- Akademik Jasar Redzepagic, Razvoj i obelezja turski skola na teritoriji danasnje Jugoslavije do 1912 godine. "Studije" Pristina, 1988
- Shinazi Memedi, Objektet fetaro islame dhe vakëfet në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918-1941, Bashkësia Fetare Islame në RM, Shkup, 2017
- Mr. Taxhedin Bislimi, Vakëfi në Maqedoni 1391-2001, Muftinia BI – Shkup, 2007
- Lidija Kumbaradži-Bogoević, Osmanliski spomenici vo Skopje, Islamska zaednica vo RM-Skopje, Sektor za Nauka i Islamska Kultura, Skopje, 1998
- Glasnik islamske Vjerske Zajednice, Kraljevine Jugoslavije, broj 1, Sarajevo, januar 1937
- Naser Ramadani, Depërtimi Osman në Maqedoni dhe zhvillimi i arsimit Islam gjatë shekujve IX-X h. (XV-XVI), Shkup, 2010
- <https://medreseja-isabeu.com/reth-medreses/>
- <https://medreseja-isabeu.com/zeqati-dhe-ndihmat-per-medresene-arme-per-fugizimin-e-fjales-se-allahut/>
- <https://medreseja-isabeu.com/medreseja-isa-beu-dhe-paralelet-e-saja/qender/>
- <https://medreseja-isabeu.com/reth-medreses/>
- Prof. Bahri Aliu, Medreseja Isa Beu vatër e arsimimit dhe e edukimit të gjeneratave të dikurshme, të sotme dhe të nesërme, (Referat i lexuar në Konferencën ndërkombëtare në Tiranë e organizuar nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC) dhe Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) respektivisht Tivar. të Malit të Zi, tetor 2016. <https://bahrialiu.com/wp-content/uploads/2019/10/MEDRESEJA-ISA-BEU-VAT%C3%8BR-E-ARSIMIMIT-DHE-E-EDUKIMIT.pdf>
- <https://medreseja-isabeu.com/reth-medreses/>

- Ibrahim Idrizi, Hëna e Re nr. 336, shtator 2019
- <https://bfi.mk/dega-e-vajzave-ne-tetove/>
- <https://bfi.mk/dega-e-vajzave-ne-shkup/>
- Ibrahim Idrizi, Hëna e Re nr. 336, shtator 2019 f, 30
- <https://bfi.mk/dega-e-vajzave-ne-gostivar/>
- Medreseja Q.R. Isa Beu, Arkivi Shtetëror R.M. në Shkup, K. 3. 1. 953. 3. 3. 554-555.
- <https://medreseja-isabeu.com/plan-programi/>
- <https://medreseja-isabeu.com/administrata/drejtori/>
- Malhotra dhe Birks 2003, f.85
- Gill & Johnson, 1997.
- Julia Turner, The Big Red Word vs. the Little Green Man, Slate, 8 March 2010.
- Sherif Ahmeti: Kurani përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Kaptina Nahl: 125.
- <https://bfi.mk/sot-date-24-10-2018-prof-dr-shaban-sulejmani-zgjidhet-dekan-fakultetit-te-shkencave-islame-shkup/>
- <https://fshi.edu.mk/shkencave-juridike-iu-shtua-edhe-nje-doktor-shkence/>
- <https://bfi.mk/sot-date-24-10-2018-prof-dr-shaban-sulejmani-zgjidhet-dekan-fakultetit-te-shkencave-islame-shkup/>